

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Integriteti

dhe

Korrupsioni

Policor në Shqipëri

3.0

Tiranë, 2020



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands

Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri 3.0

Tiranë, 2020

Autorë:

Mimoza Agolli
Rovena Sulstarova
Besjana Kuçi

Koordinatorët në terren:

Dior Angjeli

Përktheu në shqip:

Durim Tabaku

© 2020 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

ISBN _____

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H. 1, 1017

Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

www.idmalbania.org

Ky studim u realizua në kuadër të Projektit “Ndërtimi i integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së anti-korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” projekt i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës. Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Holandeze



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport synon të mbështesë përpjekjet anti-korrupsion të Policisë së Shtetit në Shqipëri: (i) duke kuptuar perceptimin e publikut për korrupsionin në polici dhe duke identifikuar faktorët kryesorë që çojnë në praktika korruptive; (ii) duke marrë mendimin e të anketuarve në radhët e Policisë së Shtetit për korrupsionin dhe faktorët, qofshin këta faktorë ligjorë, institucionalë apo kulturorë, që mundësojnë korrupsionin në polici; dhe (iii) duke vlerësuar situatën në lidhje me korrupsionin dhe nxitësit e korrupsionit me kalimin e kohës, duke identifikuar fushat ku janë bërë hapa para ose prapa në këtë drejtim.

Nga një krahasim i perceptimit të publikut dhe atij të policisë për korrupsionin në Policinë e Shtetit evidentohet vazhdimisht një hendek mes asaj që perceptohet nga publiku i gjerë dhe asaj që perceptojnë vetë punonjësit e policisë. Me kalimin e kohës, perceptimi i korrupsionit, i matur nga rezultatet e sondazhit, mund të paraqitet si një kurbë e përmbytur U, ku korrupsioni perceptohet se përkeqësohet gjatë viteve 2014 dhe 2016, por me përmirësim të vogël në studimin e vitit 2020.

Publiku i gjerë konfirmoi se për ta ishte më se e zakonshme të dëgjonin lajme në lidhje me korrupsionin në Policinë e Shtetit. Nga të anketuarit, 86.7% konfirmuan se në 12 muajt e fundit kishin dëgjuar për korrupsionin në polici. Ndonëse publiku deklaronte se kishin dëgjuar shpesh për korrupsionin në polici, të anketuarit nga radhët e policisë raportnin se rrallë kishin dëgjuar për të. Për më tepër, përqindja e të anketuarve nga publiku që pohonin se në Policinë e Shtetit ka korrupsion ishte 89%. Si për krahasim, studimi evidenton se perceptimi i policisë për korrupsionin është thjesht i moderuar.

Po ashtu, publiku e konsideronte korrupsionin si pjesë të sistemit dhe të përhapur në të gjitha strukturat dhe radhët e Policisë së Shtetit. Perceptimi i të anketuarve të policisë mbi seriozitetin dhe përhapjen e korrupsionit ofronte një pamje krejt tjetër ku pjesa më e madhe e konsideronin korrupsionin si thjesht raste të izoluar.

Të dy sondazhet ofrojnë informacione më të hollësishme për tipologjinë e korrupsionit në polici. Publiku i gjerë e konsideron korrupsionin përgjithësisht më të përhapur në nivelet e larta të policisë sesa tek punonjësit e nivelit të ulët dhe të mesëm. Gjithashtu, publiku citoi departamentin e trafikut të lëndëve narkotikëve dhe departamentin e policisë rrugore si drejtoritë me incidencën më të lartë të korrupsionit. Patrulla e Përgjithshme dhe Departamenti për Hetimin dhe Parandalimin e Krimin u konsideruan nga publiku si strukturat me nivel relativisht të ulët të korrupsionit.

Për më tepër, të pyetur për përvojat e tyre personale të korrupsionit me struktura caktuar të policisë, të anketuarit nga publiku pohuan më shpesh se kishin ofruar ryshfet në Departamentin e Krimin Financiar, në Policinë e Kufirit dhe Migracionit si dhe në Policinë Rrugore. Nivel i moderuar korrupsioni u raportua edhe për administratën e Policisë së Shtetit dhe Departamentin për Hetimin dhe Parandalimin e Krimin. Strukturat e Policisë së Shtetit me nivelin më të ulët të raportuar të ryshfetit ishin Patrulla e Përgjithshme dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA).

Shumica e të anketuarve nga policia raportuan se atyre nuk u është ofruar kurrë ryshfet dhe as nuk u është dhënë asnjë favor jo-monetar nga qytetarët. Një përqindje edhe më e lartë e punonjësve të policisë raportuan se nuk kanë qenë kurrë dëshmitarë të një sjelljeje të tillë. Ky konstatim në fakt bie në kundërshtim me sondazhin publik, në të cilin më shumë se 60% e të anketuarve thanë se ryshfeti dhe favorizimet janë forma korrupsioni që ndodhin ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’ në polici.

Po ashtu, punonjësit e policisë duket se e konsiderojnë korrupsionin si sjellje të një individi dhe pjesë të sistemit. Të anketuarit e policisë thanë se punonjës të caktuar të policisë korruptohen sapo bëhen pjesë e strukturave të policisë. Sondazhi i policisë ndryshon nga perceptimi i publikut në lidhje me profilin tipik të punonjësve të korruptuar – në sondazhin e policisë u identifikuan oficerë femra, të rinj, punonjës zyre dhe të rangut të ulët si me më shumë gjasa për të qenë të korruptuar sesa meshkuj, me përvojë, oficerë në terren dhe ata me gradë më të lartë.

Një në dy qytetarë që kanë ndërvepruar me Policinë e Shtetit në 12 muajt e fundit u përgjigjën se ishin në dijeni se ku mund të denonconin korrupsionin. Gjithsesi, vetëm 6% e të anketuarve thanë se kanë denoncuar një vepër korrupsioni të një punonjësi të Policisë së Shtetit. Me sa duket qytetarët ngurrojnë të denoncojnë korrupsionin dhe zgjedhin t’i zgjidhin nëpërmjet ryshfetit problemet që kanë. Edhe mungesa e informacionit se ku mund të denoncojnë korrupsionin ose ideja se denoncimi i korrupsionit ha shumë kohë renditen si arsye për të mos denoncuar rastet e korrupsionit. Sondazhi publik nxjerr në pah se Komisariati Dixhital dhe numri i gjelbër i SHÇBA janë mjete të rëndësishme që ndihmojnë në denoncimin e korrupsionit, ndërkohë që publiku raporton se praktikat korruptive denoncohen edhe përmes Prokurorisë së Përgjithshme ose në Komisaratin e Policisë.

Gjysma e qytetarëve të anketuar besonin se korrupsioni shfaqet ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’ në shpërdorimin e fondeve të Policisë së Shtetit. E njëjta përqindje e publikut të gjerë besonte se korrupsioni bën që punonjësit e policisë të manipulojnë provat ose të përdorin dhunën ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’. E kundërta raportohet në sondazhin e policisë, ku veprat e korrupsionit si ryshfeti, favorizimet, shpërdorimi i fondeve publike, abuzimi me forcën ose manipulimi i provave, shihen si fenomene që nuk ndodhin ‘kurrë’ ose ndodhin ‘rrallë’.

Si sondazhi me publikun ashtu edhe ai me policinë nxorën në pah perceptime të ngjashme të ndikimit të rekrutimit dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore të korrupsioni. Të dy sondazhet mbështetën idenë se pagat e ulëta kanë një ndikim ‘të fortë’ ose ‘shumë të fortë’ të korrupsioni. Po ashtu, publiku mendon se rekrutimi dhe ngritja në detyrë e pabazuar në meritokraci apo edhe menaxhimi i dobët kanë ndikim ‘të fortë’ dhe ‘shumë të fortë’ të korrupsionin.

Ndër faktorët me më shumë ndikim që çojnë në korrupsion, siç raportohet nga sondazhi me publikun, janë pranimi në përgjithësi i korrupsionit në shoqërinë shqiptare dhe influenca e politikës. Megjithatë, pranimi e korrupsionit dhe toleranca ndaj tij në fakt u raportuan të ishin në nivel më të ulët mes të anketuarve publikë sesa te policia. Faktorë të tjerë që mendohet se çojnë në korrupsion ishin kultura institucionale e Policisë së Shtetit dhe menaxhimi ose profesionalizmi i punonjësve të policisë, por në një shkallë më të vogël.

Në sondazhin publik u evidentua një nivel i lartë besimi në aftësinë e policisë për të luftuar korrupsionin brenda radhëve të saj. Ky besim duket është më i madh te popullsia në moshë të re. Sondazhi me policinë tregoi se duhet të përmirësohet kuadri ligjor për luftën kundër korrupsionit. Besimi në aftësinë për të luftuar korrupsionin në Policinë e Shtetit përforcohet edhe më shumë nga besimi në procesin e vetingut.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
I. HYRJE DHE KONTEKSTUALIZIMI I RAPORTIT PËR INTEGRITETIN DHE KORRUPSIONIN NË POLICI	13
I.1 Kuadri ligjor dhe i politikave për forcimin e integritetit në Policinë e Shtetit 2016–2020	13
II. METODOLOGJIA	16
II.1 Krijimi i kampionit të sondazhit publik	16
II.2 Demografia karakteristikat socio-ekonomike të kampionit të sondazhit publik	17
II.3 Karakteristikat e kampionit për sondazhin me policinë	20
III. INFORMACIONI I PUBLIKUT DHE POLICISË PËR INTEGRITETIN DHE KORRUPSIONIN NË POLICINË E SHTETIT	22
III.1 Burimet e informacionit për korrupsionin në polici	23
IV. PËRHAPJA E KORRUPSIONIT SIPAS NIVELIT TË DREJTIMIT NË POLICI	29
IV.1 Perceptimi i publikut i policisë për përhapjen e korrupsionit	30
V. KORRUPSIONI SIÇ PËRJETOHET NGA PUBLIKU DHE POLICIA	45
V.1 Korrupsioni siç përjetohet nga publiku i përgjithshëm	46
V.2 Korrupsioni siç përjetohet nga të anketuarit e policisë	56
VI. TIPOLOGJIA DHE PËRHAPJA E PRAKTIKAVE KORRUPTIVE	58
VI.1 Tipologjia e korrupsionit dhe shpeshtësia e akteve korruptive siç raportohet nga sondazhi me publikun dhe policinë	59
VI.2 Tipologjia dhe ndodhja e sjelljeve korruptive sipas sondazhit të publikut dhe atij të policisë	62

VII. NDIKIMI I FAKTORËVE KULTURORË, SJELLORË, DHE INSTITUCIONALË TE KORRUPSIONI	65
VII.1 Perceptimi i publikut dhe policisë për faktorët që ndikojnë te korrupsioni në Policinë e Shtetit	66
VII.2 Toleranca ndaj korrupsioni te publiku dhe policia	72
VIII. NJOHURITË DHE PERCEPTIMI I PUBLIKUT DHE POLICISË PËR ANTI-KORRUPSIONIN	77
VIII.1 Besimi i publikut dhe policisë në kapacitetin e policisë për të luftuar korrupsionin	78
VIII.2 Ndërgjegjësimi i publikut dhe policisë për kuadrin anti-korrupsion	78
BIBLIOGRAFIA	83
SHTOJCAT	83
Shtojca 1: Statistikat përshkruese të Sondazhit me Publikun	84
Shtojca 2: Statistikat përshkruese të Sondazhit me Policinë	101

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja e kampionit të sondazhit publik sipas qarqeve dhe vendbanimit	18
Figura 2: Shpërndarja e kampionit sipas gjinisë dhe moshës	18
Figura 3: Shpërndarja e kampionit sipas nivelit arsimor	19
Figura 4: Shpërndarja e kampionit sipas nivelit të të ardhurave	20
Figura 5: Përqindja e publikut që konfirmon se ka dëgjuar për korrupsionin në Policinë e Shtetit në 12 muajt e fundit	23
Figura 6: Përqindja e punonjësve të policisë që konfirmojnë se kanë dëgjuar për korrupsionin gjatë 12 muajve të fundit	24
Figura 7: Sa shpesh dëgjohet për korrupsionin, siç raportohet nga sondazhi me publikun	25
Figura 8: Sa shpesh dëgjohet për korrupsionin, siç raportohet nga sondazhi me policinë	26
Figura 9: Shpeshësia e marrjes së informacionit për korrupsionin në polici, siç raportohet nga sondazhet me publikun dhe policinë 2014–2020	27
Figura 10: Lloji i medias përmes së cilës publiku dhe policia informohen më shpesh për korrupsionin në polici	28
Figura 11: Perceptimi publik për pyetjen “A ka individë të korruptuar në Policinë e Shtetit?”	30
Figura 12: Të anketuar nga policia që raportojnë se ka punonjës të korruptuar policie në Policinë e Shtetit	31
Figura 13: Përqindja e të anketuarve që iu përgjigjën pyetjes: “A ka individë të korruptuar në Policinë e Shtetit? (2014–2020, në %)”	32
Figura 14: Perceptimi i publikut për nivelin e korrupsionit në polici në përgjithësi dhe sipas gradave	33
Figura 15: Perceptimi i policisë për nivelin e korrupsionit në polici sipas gradave	35
Figura 16: Perceptimi për nivelin e korrupsionit në polici siç raportohet nga sondazhi me publikun dhe me policinë 2014–2020	36
Figura 17: Ndryshimi në përqindjen e të anketuarve që mendojnë se korrupsioni është ‘shumë i përhapur dhe serioz’ sipas gradës, 2014–2020	37
Figura 18: Niveli i korrupsionit sipas strukturave të ndryshme të Policisë së Shtetit raportuar nga sondazhi me publikun	38
Figura 19: Perceptimi i policisë për përhapjen e korrupsionit sipas strukturave të ndryshme në Policinë e Shtetit	39
Figura 20: Ndryshimi në përqindjen e perceptimeve të publikut dhe policisë për përhapjen e korrupsionit sipas strukturave të Policisë së Shtetit, 2014–2020	40
Figura 21: Përqindja e të anketuarve nga publiku që janë dakord dhe nuk janë dakord me pohimet që përshkruajnë korrupsionin në Policinë e Shtetit	42
Figura 22: Përqindja e të anketuarve nga policia që janë dakord dhe nuk janë dakord me pohimet që përshkruajnë korrupsionin në Policinë e Shtetit	43
Figura 23: Ndryshimi në përqindjen e të anketuarve nga publiku dhe policia që janë dakord me pohimet për korrupsionin 2014–2020	44
Figura 24: Përqindja e të anketuarve që deklarojnë se kanë pasur kontakt me policinë në 12 muajt e fundit	47
Figura 25: Përqindja e publikut që deklaroi se kishte pasur kontakt me punonjës të policisë në 12 muajt e fundit, sipas strukturave të ndryshme	48
Figura 26: Të anketuarit nga publik që u është kërkuar shprehimisht rryshfet nga punonjësi i policisë në 12 muajt e fundit, kundrejt ofrimit të rryshfetit një punonjësi policie në 12 muajt e fundit	49
Figura 27: Reagimi i punonjësit të policisë kur i është ofruar rryshfet, sipas të intervistuarve nga publiku	51
Figura 28: Përqindja e të anketuarve nga publiku që dinë se ku të denoncojnë praktikant korruptive	52

Figura 29: Shpeshësia e denoncimit nga publiku të rryshfetit (apo tentativës për rryshfet) nga një punonjës i Policisë së Shtetit	53
Figura 30: Arsyet kryesore pse nuk denoncohet korrupsioni	54
Figura 31: Sa shpesh përjetojnë praktika korruptive punonjësit e policisë	56
Figura 32: Sa shpesh punonjës të policisë bëhen dëshmitarë të praktikave korruptive	57
Figura 33: Ndodhja e akteve të korrupsionit mes punonjësve të Policisë së Shtetit, siç raportohet nga publiku	60
Figura 34: Ndodhja e akteve të korrupsionit mes punonjësve të Policisë së Shtetit, siç raportohet nga policia	60
Figura 35: Përqindja e ndryshimit të të anketuarve që raportojnë se praktikatat korruptive ndodhin “shumë shpesh”, sipas sondazhit të publikut dhe të policisë, 2014–2020	61
Figura 36: Perceptimi i publikut për praktikatat korruptive në rekrutimin, udhëheqjen dhe prokurimin nga Policia e Shtetit	63
Figura 37: Perceptimi i policisë për praktikatat e korrupsionit në rekrutimin, udhëheqjen dhe prokurimet nga Policia e Shtetit	64
Figura 38: Perceptimi i publikut për faktorët që ndikojnë në korrupsionin në Policinë e Shtetit	67
Figura 39: Perceptimi nga publiku dhe policia e ndikimit të fortë të faktorëve të ndryshëm të korrupsioni	68
Figura 40: Perceptimi nga policia e ndikimit të faktorëve të korrupsioni	69
Figura 41: Perceptimi i publikut për kushtet e punës së policisë	70
Figura 42: Perceptimi i të anketuarve nga policia për kushtet e tyre të punës	71
Figura 43: Kushtet e punës dhe kultura institucional sipas sondazhit të policisë	72
Figura 44: Perceptimi publik për korrupsionin në situata të ndryshme	73
Figura 45: Perceptimi i policisë për korrupsionin në situata të ndryshme	74
Figura 46: Opinioni publik për vepra/situata që tolerohen si jo korrupsion	75
Figura 47: Përqindja e punonjësve të policisë që i konsiderojnë pohimet e listuara si vepra jo-korruptive	76
Figura 48: Përqindja e të anketuarve nga publiku dhe policia që besojnë në aftësinë e policisë për të luftuar korrupsionin	78
Figura 49: Niveli i njohurive për kuadrin ligjor dhe strategjik anti-korrupsion të anketuarit e publikut dhe policisë	79
Figura 50: Përqindja e të anketuarve që e konsiderojnë kuadrin ligjor anti-korrupsion të përshtatshëm, sipas sondazhit të publikut dhe policisë	80
Figura 51: Përqindje e publikut që raporton se kanë informacione për procesin e vetingut në polici	81
Figura 52: Përqindja e të anketuarve nga publiku dhe policia që raportojnë se kanë besim të procesi i vetingut	82

Lista e tabelave

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit të policisë	21
Tabela 2: Shpeshësia e kërkesës dhe ofrimit të rryshfetit të një punonjës policie, 2014–2020	50
Tabela 3: Informimi i publikut për denoncimin e korrupsionit, 2014–2020	55
Shtojca 1: Statistikat përshkruese të Sondazhit me Publikun	78
Shtojca 2: Statistikat përshkruese të Sondazhit me Policinë	78

HYRJE

Pavarësisht reformave të vazhdueshme, Policia e Shtetit (PSH) në Shqipëri mbetet një institucion i ekspozuar ndaj korrupsionit dhe shkeljeve. Procesi aktual i vetingut është kyç për forcimin e besimit të publikut në agjencitë e zbatimit të ligjit, për garantimin dhe promovimin e integritetit profesional dhe për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve që punojnë në institucionet përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Në këtë raport kërkimor shqyrtohen aspektet e integritetit të policisë në PSH gjatë këtyre viteve. Për qëllime të këtij raporti, integriteti i policisë përkufizohet si rezistenca e policisë ndaj tundimeve për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre¹. Objektivi kryesor është të ofrojë këndvështrime në lidhje me nevojën për të forcuar integritetin e institucionit të policisë si mjet për të frenuar korrupsionin. Për më tepër, në raport ofrohen prova që shërbejnë për vlerësimin e efikasitetit të masave anti-korrupsion në PSH.

Në këtë raport prezantohen gjetjet nga sondazhi i perceptimit publik dhe atij të punonjësve të policisë të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës korrik-gushtit 2020 me kampion përfaqësues kombëtar me qytetarë dhe punonjës policie në strukturat e Policisë së Shtetit në Shqipëri. Ky raport hulumtimi kryhet për herë të tretë (2014–2016–2020) duke përdorur instrumente të ngjashëm vëzhgimi.

Raporti fillon me një vlerësim të kuadrit ligjor dhe të politikave për forcimin e integritetit të Policisë së Shtetit 2016–2020, ndjekur nga një përshkrim i metodologjisë, qasjen e tij të dhënave dhe analizat dinamike si dhe karakteristikat demografike dhe social-ekonomike të kampionit. Raporti është i ndarë në gjashtë pjesë, ku secila trajton dhe kombinon pjesë të veçanta të sondazheve me publikun dhe policinë të kryera gjatë këtyre viteve.

Pjesa e parë fokusohet te burimet e informacionit për korrupsionin në polici dhe synon të evidentojë se si krijohet perceptimi i publikut dhe i policisë për integritetin dhe korrupsionin në polici përmes burimeve të ndryshme të informacionit.

Në pjesën e dytë ofrohen këndvështrime për perceptimin e publikut dhe policisë për përhapjen e korrupsionit në organet e policisë. Pjesa tjetër përqendrohet në korrupsionin e përjetuar nga vetë publiku dhe policia. Pas përvojës së përjetuar me praktikën korruptive, në pjesën e katërt jepen informacione për tipologjinë dhe shpeshësinë e praktikave korruptive, siç raportohen nga publiku dhe të anketuarit nga policia.

Në pjesën e pestë trajtohen përgjigjet për ndikimin e faktorëve kulturorë, sjellorë dhe



1 Sanja Kutnjak Ivković, M. R. and Robert Peacock, “Overlapping Shades of Blue: Exploring Police Officer, Supervisor, and Administrator Cultures of Police Integrity” in *Exploring Police Integrity Novel Approaches to Police Integrity Theory and Methodology* (Springer 2019), f. 35.

institucionalë në korrupsionin në polici. Duke pasur parasysh politikat e vazhdueshme dhe reformat ligjore në Policinë e Shtetit, pjesa e fundit ofron këndvështrime të rëndësishme për njohuritë dhe perceptimin e publikut dhe të policisë për kuadrin anti-korrupsion.

Shtojcat në pjesën e fundit të raportit ofrojnë statistika integrale përshkruese për sondazhin me publikun dhe atë me punonjësit e policisë për të bërë të mundur analizë të mëtejshme të të dhënave të mbledhura.

I. HYRJE DHE KONTEKSTUALIZIMI I RAPORTIT PËR INTEGRITETIN DHE KORRUPSIONIN NË POLICI

I.1 Kuadri ligjor dhe i politikave për forcimin e integritetit në Policinë e Shtetit 2016–2020

Lufta kundër korrupsionit në polici është me rëndësi të jashtëzakonshme për ruajtjen e shtetit ligjor dhe forcimin e besimit tek institucionet publike. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian është një nga aspektet më të rëndësishme në kuadër të luftës kundër korrupsionit. Kjo rritje e angazhimit në nivel ndërkombëtar është rrjedhojë e rëndësishme e reformave të fundit të ndërmarra në Policinë e Shtetit, siç është nisja e procesit të vetingut², i cili synon të zhdukë korrupsionin në të gjitha format e tij.

Në vitin 2017, pas raportimeve në media dhe rritjes së akuzave në lidhje me përfshirjen e Policisë së Shtetit në trafikun e drogës, Ministria e Punëve të Brendshme u detyrua të marrë masa për t'i dhënë zgjidhje kësaj shtetësuese. Ministri ngriti një grup pune për të ndërmarrë një analizë të plotë të korrupsionit brenda strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA).³ Bazuar në analizën e plotë të situatës, u propozua nisja e procesit të vetingut në polici si instrument për luftën kundër korrupsionit. Qëllimi kryesor i vetingut në Policinë e Shtetit do të ishte garantimi dhe promovimi i integritetit dhe rritja e profesionalizmit në radhët e punonjësve të agjencive përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike⁴. Procesi i vlerësimit do



2 Shih Ligjin Nr. 74/2020 (18/6/2020), me shtesat dhe ndryshimet në Ligjin Nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme” Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 39, 2379–2435, <https://qzb.gov.al/eli/fz/2018/39/e052fc58-ab5d-4f90-ae18-9cfcc907f678>.

3 Urdhri i Ministrit të Brendshëm, Nr. 904 (15/9/2017)

4 Ministria e Brendshme, ‘Vetingu në Polici: Udhëzues për vlerësimin e punonjësve në PSH, GR, SHÇBA’, p. 4.

të zbatohet nga organe të pavarura dhe do të bazohet në vlerësimin e integritetit personal, kontrollin e pasurive personale dhe vlerësimin e profesionalizmit të oficerëve të policisë.

Ky objektivi politik solli si rezultat miratimin e Ligjit Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe SHÇBA në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, i cili hyri në fuqi në 4 prill 2018⁵. Nën fazën kalimtare të procesit, Komisioni i Vlerësimit të Jashtëm (KVJ) së pari do të kryente vlerësimin e oficerëve të lartë të policisë, të përbërë nga pothuajse 300 punonjës të rangut të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës Republikane dhe SHÇBA. Me ndryshimet ligjore të miratuara në gusht 2020, anëtarët e vetuar me sukses të SHÇBA do të ndihmojnë më pas KVJ në vlerësimin e 12,000 punonjësve të nivelit të mesëm dhe të ulët të policisë. Këto dispozita u parashikuan në ndryshimet e reja ligjore për funksionimin e SHÇBA për t’i mundësuar asaj kryerjen e kësaj detyre.⁶

Vlerësimi kalimtar i punonjësve të policisë ka ecur me ritme të ngadalta, vlerësim që filloi 9 muaj pas afatit. Vonesa ka ardhur për shkak të konstituimit të organeve të vlerësimit, nevojës për nxjerrjen e akteve nënligjore për mbarëvajtjen e gjithë procesit, ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KVJ-së dhe Sekretariatit Teknik si dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme financiare dhe logjistike për procesin.⁷

Si pjesë e përpjekjeve për të forcuar integritetin e policisë, Ligji “Për Policinë e Shtetit” pësoi disa ndryshime në vitet 2017 dhe 2018. Ndryshimet e miratuara bënë të mundur rregullimin e procedurave të personelit në Policinë e Shtetit (PSH), përfshirë proceset për dhënien e gradave, shtimin e dy gradave në nivelin bazë të policisë me kriteret e tyre, ndryshimin e disa emërtimeve dhe përcaktimin e standardeve për emërimin, caktimin, certifikimin e besueshmërisë dhe policimin vullnetar, etj. Ndryshimet e fundit ligjore ofrojnë mundësitë që të diplomuarit universitarë në disa lëndë si ekonomi, informatikë dhe drejtësi të integrohen në strukturat hetimore të Policisë së Shtetit pasi të kalojnë një periudhë arsimimi dhe trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

Për më tepër, sipas Ligjit Nr. 60/2016,⁸ dispozitat e reja për sinjalizuesit në sektorin publik vlejné edhe për shërbimin e policisë. Policia e Shtetit, në mënyrë të veçantë, do t’i duhet të krijojë kanale të brendshme që u bënë të mundur punonjësve të policisë të denoncojnë sjellje të pahijshme në vendin e punës, të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit të tyre dhe të mbrojnë sinjalizuesit nga çdo hakmarrje ose diskriminim.

Për më tepër, në Shqipëri u krijua një kuadër politikash për parandalimin dhe luftën



- 5 Ligji Nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
- 6 Ligji Nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”
- 7 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ‘Raporti i Monitorimit të Procesit të Vetingut në Polici 2020’, gjendet në adresën: <https://idmalbania.org/download/7927/>
- 8 Ligji Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

kundër korrupsionit si dhe për forcimin e integritetit të Policisë së Shtetit⁹. Strategjia e Rendit Publik 2015–2020¹⁰ është dokumenti kryesor strategjik i Policisë së Shtetit në kuadër të luftës kundër korrupsionit. Qëllimi i kësaj strategjie është të rivlerësojë zbatimin e ligjit dhe të përmirësojë standardet e sigurisë në vend. Në objektivat e strategjisë bëjnë pjesë: i) përafrimi i legjislacionit dhe organizimi i PSH sipas standardeve të BE; ii) trajnimi dhe kualifikimi e punonjësve të policisë; iii) përmirësimi i kushteve të punës; dhe iv) përmirësimi i menaxhimit të brendshëm të PSH. Strategjia parashikon edhe një sërë masash anti-korrupsion që përfshijnë ndryshime organizative në Policinë e Shtetit, të tilla si reformimi i sistemit të menaxhimit për zhvillimin e mekanizmave të llogaridhënies; ndryshimi i menaxhimit të burimeve njerëzore (në rekrutim dhe në ngritjen në detyrë); krijimi i një sistemi ankesash për qytetarët; dhe institucionalizimi dhe forcimi i transparencës publike brenda PSH. Disa nga këto objektiva u bënë pjesë e reformave legjislative për Policinë e Shtetit në vitin 2018.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (SNKK) 2015–2020 është dokumenti kryesor politik kundër korrupsionit.¹¹ Sipas tij, është me rëndësi të madhe që në disa sektorë shtetërorë që priren drejt korrupsionit (p.sh., policia, prokurimet, tatimet, gjyqësori, etj.), sektori i personelit të miratojë dhe zbatojë metoda që testojnë integritetin e kandidatëve të mundshëm si edhe të atyre që janë aktualisht të punësuar. Plani i Veprimit 2020-2023 e vë në zbatim këtë objektiv të SNKK-së duke siguruar hartimin dhe miratimin e një plani integriteti dhe të mekanizmave anti-korrupsion për secilin sektor publik në vend, përfshirë këtu edhe Policinë e Shtetit. Në planin e integritetit do të ofrohet kuadri konceptual për politikën dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të punonjësve të policisë dhe për monitorimin e efekteve të masave menjëherë pasi të jenë zbatuar ato në një institucion.

Praktika e deritanishme ka treguar se, pavarësisht nga moria e dokumenteve të politikave dhe reformave legjislative të miratuara, lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë një përparësi kryesore për Shqipërinë. Megjithatë, këto korniza politike dhe ligjore duhet t'i bëjnë të mundur Policisë së Shtetit të luftojë korrupsionin me më shumë efektivitet, duke forcuar në mënyrë të veçantë transparencën, integritetin dhe llogaridhënien e punonjësve të policisë në vend.



9 Dokumentet kryesore janë: Dokumenti i politikave prioritare në fushën e rendit dhe sigurisë, miratuar nga Ministria e Brendshme, shtator 2017; Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013–2020; Strategjia e Rendit Publik dhe Plani i Veprimit 2015–2020; Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2020; Plani i Veprimit 2018–2020; dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020.

10 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 702 (datë 26/8/2015), “Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015–2020 dhe Plani i Veprimit 2015–2017”, gjendet në adresën: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Strategjia_e_Rendit_Publik_2015%E2%80%9C2020_dhe_Plani_i_Veprimit_2015%E2%80%9C2017.pdf

11 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 247 (datë 20/03/2015), “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015–2020”, Fletorja Zyrtare, 31 mars 2015, gjendet në adresën: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/472015.pdf

II. METODOLOGJIA

Në këtë raport përmbledhet dhe krahasohet perceptimi i publikut për integritetin dhe korrupsionin me policinë dhe bëhet një vetëvlerësim i përhapjes dhe seriozitetit të korrupsionit mes individëve dhe strukturave në Policinë e Shtetit. U realizuan dy sondazhe: një sondazh publik me një kampion përfaqësues kombëtar dhe një sondazh me punonjës të policisë me një kampion të përshtatshëm për të siguruar përfaqësueshmëri dhe besim statistikor të rezultateve. Vlerësimi i integritetit të Policisë së Shtetit ndërmerret nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për të tretën herë radhazi (dy herët e mëparshme ishin në vitet 2014 dhe 2016). Po ashtu, raporti ofron një perspektivë dinamike duke krahasuar perceptimin e publikut dhe atë të policisë për integritetin në Policinë e Shtetit në periudhën 2014-2020. Në këtë kapitull përshkruhet metodologjia e këtij raporti, i cili bazohet kryesisht në sondazhet, në qasjen për analizën e të dhënave dhe në analiza dinamike.

II.1 Krijimi i kampionit të sondazhit publik

Sondazhi kombëtar për “Integritetin dhe Korrupsionin në Policinë e Shtetit” synon të ofrojë një tregues të perceptimit të publikut për korrupsionin në Policinë e Shtetit në Shqipëri. Pyetësi u hartua për të kuptuar korrupsionin si perceptim, korrupsionin si informacion dhe korrupsionin siç përjetohet nga publiku. Korrupsioni ka dobësuar integritetin e Policisë së Shtetit dhe përpjekjet për ta rikthyer këtë integritet kanë qenë në qendër të reformave kryesore në nivel kombëtar. Kështu, sondazhi ofron pikëpamje të rëndësishme në lidhje me ndikimin e reformave anti-korrupsion në integritetin e policisë.

Sondazhi me publikun u zbatua në nivel kombëtar, me një kampion përfaqësues të zgjedhur përmes metodologjisë së përcaktimit të kampionit në mënyrë rastësore dhe me shtresa. Shtresëzimi i kampionit bazohet në tiparet e shpërndarjes së popullsisë, tipare që u përdorën për të përcaktuar kuotat përfaqësuese të kampionit për çdo shtresë. Karakteristikat e përdorura për popullsinë për shtresat dhe kuotat e kampionit janë: shpërndarja e popullsisë për secilin qark, e kombinuar me shpërndarjen urbane/rurale, dhe shpërndarja gjinore e popullsisë së moshës mbi 18 vjeç.

Identifikimi i kuotave të kampionit për secilin qark u bazua në një funksion të përzgjedhjes së rastësishme, nëpërmjet të cilit shpërndahen kuotat e qarqeve për secilën njësi administrative. Funksioni i rastësishëm u bazua në një funksion probabiliteti të shpërndarjes normal me probabilitetin e përzgjedhjes që ishte i barabartë me kuotën e kampionit me popullsinë. Njësitë e identifikimit të kampionit u mbështetën në hartën administrative të secilit rajon. U aplikua një procedurë përzgjedhjeje e rastësishme për të përzgjedhur mes njërive administrative derisa të plotësoheshin kuotat. Pas përzgjedhjes së njërive administrative, intervistuesit u pajisjen me informacione për shpërndarjen e kampionit për secilën njësi administrative dhe kuotat përkatëse gjinore, për përzgjedhjen e terrenit. Pyetësi u administrua në intervista ballë për ballë me metodën e plotësimi të

pyetësorit në letër nga 30 intervistues terreni të trajnuar administruan.

Tabela me detaje për shpërndarjen dhe identifikimin e kampionit jepet në Shtojcën 1. Të dhënat u kombinuan me ato popullsisë të marra nga regjistri civil i vitit 2019, ndërsa shpërndarja urbane/rurale dhe kuotat gjinore u zbatuan duke përdorur tiparet demografike të nxjerra nga të dhënat e popullsisë që publikohen nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

Kampioni është projektuar për të qenë përfaqësues i popullsisë dhe siguron që statistikave dhe informacionet e siguruar përmes këtij sondazhi të vlejshme për të gjithë popullatën. Marzhi i gabimit përcakton hapësirën ku statistikave të popullsisë mund të devijojnë nga statistikave të kampionit. Madhësia e kampionit u rumbullakos në 1,100 intervista, duke pasur parasysh probabilitetin e përzgjedhjes, duke siguruar një besueshmëri statistikore të rezultateve me 95%. Marzhi i gabimit i rezultateve të këtij studimi vlerësohet të jetë $\pm 2.15\%$.

Puna në terren për këtë studim u krye gjatë periudhës korrik-gusht 2020, ndërsa instrumenti i sondazhit u testua dhe u konsultua me aktorët kryesorë të interesit, veçanërisht me përfaqësues nga Policia e Shtetit, organizatat partnere që punojnë në fushën e anti-korrupsionit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të tjerë të anti-korrupsionit.

Sondazhi për integritetin e Policisë së Shtetit zbatohet për herë të tretë, ku raundi i parë u realizua në vitin 2014 dhe i dyti në vitin 2016. Në hartimin dhe rishikimin e pyetësorit u mor parasysh nevoja për të pasur të dhëna të krahasueshme gjatë të tre rraundeve për të siguruar që tiparet kryesore të shpërndarjes së kampionit dhe përmbajtja e pyetësorit të jenë të krahasueshme me ato të aplikuara në vitet 2014 dhe 2016. Karakteristikave të kampionit na bëjnë të mundur që rezultatet të jenë të krahasueshme, pasi ato nxirren në mënyrë të rastësishme nga e njëjta popullatë. Gjithsesi, seti i të dhënave nuk është plotësisht i integruar në panel, me të njëjtin raportim individual në vitet 2014, 2016 dhe 2020. Kjo do të reflektohet në analizat dinamike dhe krahasimin kohor të treguesve kryesorë.

Analizat statistikore të raportit të sondazhit dhe analizat e perceptimit të publikut për integritetin e Policisë së Shtetit do të bazohen në statistikave përshkruese që na ndihmojnë të nxjerrim përfundime. Krahasimi tabular dhe analizat e formave u kryen duke përdorur metodologjinë ANOVA, që është një metodologji e rëndësishme për evidentimin e ndryshimeve me rëndësi statistikore.

II.2 Demografia karakteristikave socio-ekonomike të kampionit të sondazhit publik

Shpërndarja e kampionit imiton gjeografikisht shpërndarjen e popullsisë pa ndonjë mospërputhje mes përqindjes së popullsisë sipas qarkut dhe përqindjes së kampionit. Tirana përfaqëson përqindjen më të madhe të kampionit, me 29% të numrit të intervistave. Qarqet e Elbasanit, Durrësit dhe Fierit përfaqësojnë përkatësisht 11%, 12% dhe 10% të kampionit të intervistuar. Qarqet në veri të vendit, Dibra, Kukësi, Shkodra dhe Lezha, përfaqësojnë së bashku 18% të kampionit, ndërsa qarqet juglindore dhe jugore, Korça, Berati, Gjirokastra dhe Vlora, përbëjnë pjesën e mbetur të 20% të kampionit. Zonat urbane përfaqësojnë 56% të kampionit, ndërsa 44% e të anketuarve vijnë nga zonat rurale. (Shih Figurën 1).

Të anketuarat femra përfaqësojnë 50.5% të individëve të intervistuar, ndërsa shpërndarja sipas grupmoshave është pothuajse e barabartë. Individët e moshës 26-35 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 21.8%. Edhe të intervistuarit në moshë të re dhe të moshuarit janë të përfaqësuar mirë, ku të rinjtë e moshës 18-25 vjeç përbëjnë 15.5% të kampionit dhe të moshuarit (mbi 65 vjeç) përfaqësojnë 9.4% të kampionit. Pjesa tjetër e individëve të intervistuar hyjnë në kategoritë e grupmoshës 36-45 vjeç (18.6%) dhe 46-55 vjeç (15.0%). (Shih Figurën 2).

Figura 1: Shpërndarja e kampionit të sondazhit publik sipas qarqeve dhe vendbanimit (në %, N=1099)




Figura 2: Shpërndarja e kampionit sipas gjinisë dhe moshës (në %, (N=1099))






Figura 3: Shpërndarja e kampionit sipas nivelit arsimor (në %, N=1097)

Vetëm një përqindje e vogël (1.3%) e individëve të anketuar raportuan se nuk kishin arsim. Individët që kanë përfunduar arsimin fillor dhe 8/9-vjeçar përfaqësojnë 25.1% të kampionit, ndërsa 43.8% e të anketuarve të kampionit kanë përfunduar arsimin e mesëm. Një tjetër 29.8% e individëve të anketuar raportuan se kishin mbaruar arsimin universitar ose pasuniversitar. (Shih Figurën 3).

Në përgjithësi, 56% e individëve të anketuar janë në marrëdhënie pune; punonjësit e sektorit privat përfaqësojnë 44% të kampionit, ndërkohë që 12% e të punësuarve punojnë në sektorin publik. Një tjetër 23% e kampionit raportojnë se nuk janë pjesë e tregut të punës, sepse janë studentë apo njerëz që kanë dalë në pension. Të anketuarit e papunë përbëjnë 21% të kampionit. Shkalla e papunësisë është pak më e lartë te gratë sesa te burrat. Po ashtu, gratë duket se kanë përqindje më të lartë të të punësuarve në sektorin publik në krahasim me burrat. (Shtojca 2).

Shpërndarja e të ardhurave sipas të anketuarve duket se anon mjaft, ku kemi përfaqësim më të lartë të niveleve me të ardhura më të ulëta. Kjo shpërndarje të ardhurash është mjaft tipike për vendet në zhvillim. 31% e popullatës së intervistuar raporton se nuk ka burime të ardhurash. Kategoria “nuk kam të ardhura” përfshin të papunët dhe popullsinë në moshë pune që nuk marrin pjesë në tregun e punës (rreth 30% e individëve të anketuar janë ose studentë ose të papunë, pa burim të ardhurash, shih Shtojcën 2). Në grupin me të ardhura më të ulëta sipas shpërndarjes, ata që raportojnë të kenë të ardhura deri në 50,000 lekë/muaj përbëjnë rreth 50% të individëve të anketuar. Pas kësaj, vijnë 11.1% e të anketuarve që kanë të ardhura mbi mesataren, ndërsa përqindja e atyre që raportojnë të kenë të ardhura në grupin me më shumë të ardhura sipas shpërndarjes (të ardhura mbi 70,000 lekë në muaj) është vetëm 3.1% e kampionit. Të ardhurat e grave janë statistikisht më të ulëta se të ardhurat e burrave në popullatën e anketuar. Diferenca të mëdha në shpërndarjen e të ardhurave vihen re edhe mes zonave urbane/rurale dhe sipas sektorit të punësimit. (Shih Figurë 4 dhe Shtojcat.)

Figura 4: Shpërndarja e kampionit sipas nivelit të të ardhurave (në %, N=1099)

II.3 Karakteristikat e kampionit për sondazhin me policinë

Sondazhi i perceptimit publik për integritetin dhe korrupsionin në Policinë e Shtetit do të krahasohet me perceptimin e policisë. Duhet të analizohet dhe kuptohet çdo ndryshim mes vetë-perceptimit të policisë dhe perceptimit të publikut. Ndonjëherë, një hendek i tillë mund të lindë nga mungesa e komunikimit. Herë të tjera, kjo gjë evidenton mungesën e përfshirjes së aktorëve kryesorë në reformat strategjike. Cilado qoftë arsyeja, është me rëndësi të forcohet angazhimi dhe komunikimi mes publikut dhe Policisë së Shtetit në mënyrë që të përmirësohet integriteti dhe besimi i publikut.

Kampioni për sondazhin e policisë u përcaktua për të siguruar besueshmërinë statistikore, ku probabiliteti i përfshirjes së secilit punonjës policie (qoftë i nivelit të lartë apo të ulët) në kampion ishte 2.3%; kështu nga një popullatë prej 10,958 oficerësh policie 25 u përfshinë në kampion. Identifikimi në terren ishte një proces i rastësishëm, ndërsa sondazhi u përfundua përmes intervistave ballë për ballë. Madhësia e kampionit dhe probabiliteti i përzgjedhjes sigurojnë që gabimi në matje të jetë i ngjashëm me atë të sondazhit publik, i vlerësuar në $\pm 2.4\%$.

Të anketuarit meshkuj në sondazhin e policisë përbënin 72% të kampionit. Oficerët e policisë në moshë të re (18-24 vjeç) përbënin vetëm 6% të kampionit; oficerët e policisë të moshës 25-34 dhe 44-55 vjeç përfaqësojnë pjesën më të madhe të numrit të anketuar, së bashku përfaqësojnë 60% të kampionit. Pjesa e mbetur prej 17% e kampionit janë oficerë të moshës mbi 55 vjeç. (Shih Tabelën 1).

Punonjësit me arsim universitar dhe pasuniversitar përbënin 60% të kampionit. Plot 20% e oficerëve të anketuar kanë më pak se 5 vjet përvojë pune, 43% e të anketuarve kanë 5 deri në 20 vjet përvojë pune dhe vetëm 7% e oficerëve kanë punuar për më shumë se 30 vjet në

Policinë e Shtetit. 66% e oficerëve të anketuar janë oficerë në terren, me pjesën tjetër 34% janë policë që punojnë në zyrë. Shpërndarja e kampionit sipas strukturës ose ndarjes është: Policia Rrugore (7%); Policia Kriminale (15%); Policia e Rendit Publik dhe Sigurisë (48%); Policia e Kufirit dhe Migracionit (19%); ndërsa pjesa tjetër e departamenteve përbëjnë 11% të kampionit. (Shih Tabelën 1).

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit të policisë

Kategoria	Shpeshtësia (në nr)	Shpeshtësia (në %)	Kategoria	Shpeshtësia (në nr)	Shpeshtësia (në %)
Gjinia			Punonjës në terren/zyrë		
Mashkull	182	72%	Po	167	66%
Femër	72	28%	Jo	85	34%
Mosha (vite)			Gradat		
18-24	15	6%	Inspektor	153	60%
25-34	79	31%	Nënkomisar	53	21%
35-44	44	17%	Komisar	14	5%
44-55	73	29%	Kryekomisar	13	5%
Mbi 55	43	17%	Drejtues	2	1%
			Personel pa uniformë	20	8%
Arsimi			Lloji i shërbimit		
Arsim i mesëm	100	39%	Policia Kriminale	38	15%
Arsim universitar	115	45%	Policia Rrugore	17	7%
Arsim pas-universitar	39	15%	Policia e Kufirit dhe Migracionit	49	19%
Përvoja			Policia e Rendit Publik dhe Sigurisë		
Më pak se 5 vjet	51	20%	Shërbimet Mbështetëse	13	5%
5-10 vjet	44	17%	Akademia e Sigurisë	1	0%
11-20 vjet	67	26%	Të tjera (punonjës civilë)	15	6%
21-30 vjet	74	29%			
Mbi 30 vjet	19	7%			

III. INFORMACIONI I PUBLIKUT DHE POLICISË PËR INTEGRITETIN DHE KORRUPSIONIN NË POLICINË E SHTETIT

Informacioni dhe burimi i informacionit janë të rëndësishëm për përcaktimin e perceptimit të publikut. Në këtë pjesë të pyetësorit synohet të kuptohet se si perceptohet nga publiku dhe policia integriteti dhe korrupsioni përmes burimeve të ndryshme të informacionit.


Pikat kryesore

- Publiku konfirmoi se është shumë e zakonshme të dëgjosh lajme për korrupsionin në Policinë e Shtetit. 86.7% e individëve të intervistuar konfirmuan se kanë dëgjuar lajme për korrupsionin policor në 12 muajt e fundit.
- Madje edhe mes të anketuarve të policisë, përqindja e atyre që kanë dëgjuar apo kanë ndeshur në lajme/informacione për korrupsionin në polici është e lartë; 72% e punonjësve të policisë në këtë sondazh konfirmuan se kanë dëgjuar lajme për korrupsionin.
- Ndërkohë që publiku mendon se lajme të tilla janë të shpeshta dhe ata i dëgjojnë ato ‘shumë shpesh’ ose ‘shpesh’, punonjësit e policisë raportuan se lajme të tilla nuk janë të shpeshta, por të rralla. Përqindja e individëve që raportojnë se kanë dëgjuar lajme/informacione për korrupsionin në polici ‘gjithmonë’ ose ‘shumë shpesh’ është 53%.
- Vetëm 13% e të anketuarve nga policia raportuan se kanë dëgjuar ‘shumë shpesh’ ose ‘shpesh’ lajme për korrupsionin në polici në 12 muajt e fundit.
- Gjatë kësaj kohe shumë pak ka ndryshuar; përqindja e të anketuarve nga publiku që raportuan se kishin dëgjuar lajme/histori për korrupsionin në polici ‘gjithmonë/shpesh/ndonjëherë’ është dyfishi i atyre të intervistuar nga Policia e Shtetit. Ndërkohë që përqindja e publikut që kanë dëgjuar ‘shumë shpesh’ dhe ‘shpesh’ lajme/informacione për korrupsionin në polici u rrit paksa mes viteve 2014 –2020, përqindja e punonjësve të policisë është ulur me 3%.
- Të dy sondazhet konfirmuan se burimi më i zakonshëm mediatik nga ku merret informacioni për korrupsionin në polici është TV, me 73% të publikut dhe 53.5% e oficerëve të policisë që kanë dëgjuar lajme / marrë informacione për korrupsionin në polici përmes transmetimeve televizive. Burime të tjera të rëndësishme të informacionit për publikun evidentohet se janë miqtë/kolegët dhe mediat sociale, ndërsa për punonjësit e policisë janë mediat online (portalet online) që shpërndajnë lajme/informacione për korrupsionin në polici. Lloji i medias që raportohet si burim informacioni ndryshon në varësi të demografisë ose karakteristikave të të anketuarve. Të anketuarit më të rinj në moshë, për shembull, shfaqin një preferencë më të madhe për mediat sociale si burim informacioni.

III.1 Burimet e informacionit për korrupsionin në polici


Të anketuarit nga publiku konfirmuan se është shumë e zakonshme të dëgjosh lajme në lidhje me korrupsionin në Policinë e Shtetit. Rreth 86.7% e individëve të anketuar u përgjigjën 'po' kur u pyetën nëse kanë dëgjuar lajme për korrupsionin në Policinë e Shtetit në 12 muajt e fundit. Kjo përqindje është pak më e ulët se gratë dhe të anketuarit e moshuar, ndërkohë që është e shpeshtë në të njëjtin nivel për zonat urbane dhe rurale. (Shih Figurën 5).

Figura 5: Përqindja e publikut që konfirmon se ka dëgjuar për korrupsionin në Policinë e Shtetit në 12 muajt e fundit (në %, N=1099)



Edhe mes të anketuarve nga policia, përqindja e atyre që dëgjuan lajme për korrupsionin në polici ishte e lartë, me 72% të të anketuarve që e konfirmuan këtë gjë. Kjo ishte më e lartë tek të anketuarit nga Policia Kriminale (87%) krahasuar me departamentet e tjera; punonjësve në terren përkundër atyre në zyrë (75% krahasuar me 65%); si dhe tek oficerët e policisë me më shumë se 30 vjet përvojë pune (83%). (Shih Figurën 6).

Figura 6: Përqindja e punonjësve të policisë që konfirmojnë se kanë dëgjuar për korrupsionin gjatë 12 muajve të fundit (në %, N=253)



Shpeshësia e të dëgjuarit për korrupsion, siç raportohet nga sondazhi me publikun, mbështet konstatimin se pjesa më e madhe e njerëzve kanë dëgjuar për praktika korruptive që ndodhin në Policinë e Shtetit. Përqindja e individëve që raportojnë se dëgjojnë ‘gjithmonë’ ose ‘shpesh’ për korrupsionin në Policinë e Shtetit është dy dyfishi (53%) i përqindjes së individëve që raportojnë se kanë dëgjuar për korrupsionin ‘rrallë’ ose ‘kurrë’

(21%). Përqindja e individëve që kanë dëgjuar ‘gjithmonë’ ose ‘shpesh’ për korrupsionin në polici ishte më e lartë mes burrave, njerëzve që jetojnë në zona urbane, të anketuarve të moshës 55-56 vjeç, të papunëve, ose atyre të punësuar në sektorin privat, si dhe të individëve me nivel mesatar dhe të lartë të të ardhurave. (Shih Figurën 7.)

Shpeshësia e të dëgjuarit për korrupsion, siç raportohet në sondazhin me policinë, është krahasimisht e ulët. Vetëm 13% e të anketuarve nga policia raportuan se kanë dëgjuar ‘gjithmonë’ ose ‘shpesh’ lajme për korrupsionin në polici në 12 muajt e fundit. Punonjëset femra të policisë raportojnë se kanë dëgjuar për korrupsion më shpesh sesa punonjësit meshkuj. Të anketuar të tjerë të policisë që raportuan se kishin dëgjuar ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’ lajme për korrupsionin ishin oficerët me më pak se 5 vjet përvojë pune dhe ata që punonin në Policinë Kriminale.

Figura 7: Sa shpesh dëgjohet për korrupsionin, siç raportohet nga sondazhi me publikun (në %, N=1099)






Figura 8: Sa shpesh dëgjohet për korrupsionin, siç raportohet nga sondazhi me policinë (në %, N=253)



Përqindja e të anketuarve nga publiku që raportuan se kishin dëgjuar gjithmonë/shpesh/ndonjëherë lajme ose histori për korrupsionin në polici ka qenë dyfishi i përqindjes së të anketuarve nga Policia e Shtetit në të gjitha vitet e analizuara. Në vitin 2020, përqindja e popullsisë që dëgjonte ‘gjithmonë’ lajme/informacione për korrupsionin në polici u ul me 16 pikë përqindje (p.p.) në krahasim me vitin 2014 dhe me 11 p.p. nëse krahasohet me vitin 2016 (nga 29% në 2014 dhe 24% në 2016 në 13% në 2020). Ndërkohë, përqindja e punonjësve të policisë që raportojnë se kanë dëgjuar gjithmonë lajme/informacione për korrupsionin në polici ka rënë për të dytin raund radhazi. Kjo shpreshtësi ra me 3 p.p. në 2016 në krahasim me vitin 2014, dhe 8 p.p. në 2020 përkundër vitit 2016. (Shih Figurën 9). Ndërkohë që qytetarët dhe punonjësit e policisë vazhdojnë të dëgjojnë lajme/informacione për korrupsionin në polici, është e qartë nga rezultatet se ato arrijnë më pak shpesh te publiku. Për më tepër, përqindja e publikut dhe punonjësve të policisë që përgjigjen ‘gjithmonë’ ka rënë për të dytin raund radhazi të sondazheve.

Figura 9: Shpeshësia e marrjes së informacionit për korrupsionin në polici, siç raportohet nga sondazhet me publikun dhe policinë 2014–2020 (në %)




Të anketuarit nga publiku dhe nga policia raportuan për llojin kryesor të mediave që përdorin për të marrë lajme në lidhje me korrupsionin në polici gjatë 12 muajve të fundit. Dy kanalet më të zakonshme të informacionit për publikun janë TV dhe fjala e gojës. 73% e të anketuarve publikë raportuan se informacioni që morën në 12 muajt e fundit për korrupsionin në polici e morën përmes TV, ndërsa 62% e publikut thanë se lajmet/informacionet për korrupsionin i kishin siguruar nga miqtë/kolegët e tyre.

Sondazhi i policisë tregon se dy burimet kryesore të informacionit mbi korrupsionin për vetë policinë janë TV, siç raportohet nga 53.3% e të anketuarve, dhe media online (portalet) siç citohet nga 41.6% e të anketuarve.

Mediat sociale referohen si burim informacioni në të njëjtin nivel si nga publiku ashtu edhe nga policia; 42% e publikut dhe 32.9% e të anketuarve nga policia iu referuan mediave sociale për të marrë informacione për korrupsionin në polici. (Shih Figurën 10).

Figura 10: Lloji i medias përmes së cilës publiku dhe policia informohen më shpesh për korrupsionin në polici (në %, N=1091, N=255)



IV. PËRHAPJA E KORRUPSIONIT SIPAS NIVELIT TË DREJTIMIT NË POLICI

Pikat kryesore

- 70% e të anketuarve nga sondazhi me publikun mendojnë se korrupsioni në polici ishte ose “shumë i përhapur” ose “i përhapur”, ndërkohë që vetëm një pakicë e të anketuarve (14%) e konsideronin korrupsionin në polici si të kufizuar vetëm në pak raste të izoluara ose shumë pak të përhapur.
- Korrupsioni perceptohet nga publiku si pjesë e sistemit, i përhapur në të gjitha strukturat dhe rangjet e Policisë së Shtetit. Publiku mendon se korrupsioni është përgjithësisht më i përhapur mes gradave më të larta sesa tek oficerët e rangut të ulët dhe të mesëm. 61% e të anketuarve publik raportojnë se korrupsioni është i përhapur dhe shumë i përhapur mes drejtuesve të nivelit të lartë të “Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”; 64% e të intervistuarve perceptonin se korrupsioni ishte i përhapur dhe shumë i përhapur mes punonjësve të policisë në Drejtorinë Rajonale.
- Publiku rendit Drejtorinë e Antidrogës dhe Trafiqeve si dhe Policinë Rrugore si strukturat me korrupsion shumë të përhapur dhe të përhapur. 64% e të anketuarve raportuan se korrupsioni është i përhapur ose shumë i përhapur brenda Drejtorisë së Antidrogës dhe Trafiqeve dhe 66% e publikut raportoi se korrupsioni është përhapur më shumë në Policinë Rrugore.
- Publiku rendit Policinë e Patrullës së Përgjithshme dhe Drejtorinë e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit si strukturat me më pak korrupsion. Përqindja e të anketuarve që thanë se korrupsioni nuk është i përhapur ose jo në nivele serioze në Policinë e Patrullës së Përgjithshme ishte 65% dhe për Drejtorinë e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit 63%.


Gjithsesi, perceptimi i të anketuarve për seriozitetin dhe përhapjen e korrupsionit paraqet një pamje të kundërt. Pjesa më e madhe e të anketuarve nga sondazhi me policinë (87%) e konsideronin korrupsionin si “raste të izoluara” ose, nëse ekziston, nuk është në nivel serioz, edhe pse një nivel korrupsioni perceptohet për Policinë Rrugore dhe për Policinë e Kufirit dhe Migracionit.

- Mes punonjësve të anketuar të policisë ka një dakordësie të madhe me pohimin “Shumica e punonjësve në Policinë e Shtetit janë të motivuar për zbatimin e ligjit”. Korrupsioni perceptohet si sjellje e një individi dhe jo problem sistemi, ku 66% e të anketuarve nga policia janë dakord me pohimin “Institucioni i “Policisë së Shtetit” nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij.”

IV.1 Perceptimi i publikut i policisë për përhapjen e korrupsionit


Përqindja e publikut që bien dakord se “Në radhët e Policisë së Shtetit ka mjaft punonjës të pakorruptuar” është e lartë me 89% (N=1091). Ky perceptim është më shumë i pranishëm tek meshkujt, grupmoshat e reja dhe ata të punësuar në sektorin privat. Mes individëve që punojnë në sektorin publik, përqindja e atyre që janë dakord me të njëjtin pohim është e njëjtë në shifrën 88%. (Shih Figurën 11).

Figura 11: Perceptimi publik për pyetjen “A ka individë të korruptuar në Policinë e Shtetit?” (në %, N=1091)



Sondazhi me punonjësit e policisë tregoi se perceptimi i korrupsionit tek ta është i moderuar. Në përgjithësi, 67% e të anketuarve ranë dakord se ka persona të korruptuar në Policinë e Shtetit. Ky konfirmim është shumë më i dobët se ai i publikut të gjerë, me 22 p.p. më të ulët. Të anketuarit meshkuj e perceptonin korrupsion më shumë sesa gratë. Sa më të vjetër në moshë që janë oficerët e policisë të anketuar nga ky sondazh, aq më shpesh priren ata të mendojnë se ka oficerë të korruptuar policie. Në fakt, oficerët me jo më shumë se 5 vjet përvojë pune konfirmuan praninë e korrupsionit më rrallë sesa ata me më shumë përvojë. Nga të gjithë departamentet, punonjësit e policisë nga Policia Kriminale dhe Policia e Kufirit dhe Migracionit konfirmojnë më shpesh se ka oficerë policie të korruptuar në strukturat e policisë (përkatësisht 76% dhe 78%). Sidoqoftë, Policia Rrugore kishte përqindjen më të ulët të oficerëve që bien dakord se ka policë të korruptuar në Policinë e Shtetit, me vetëm 29%. (Shih Figurën 12).


Figura 12: Të anketuar nga policia që raportojnë se ka punonjës të korruptuar policie në Policinë e Shtetit (në %, N=253)



Perceptimi i korrupsionit mes përfaqësuesve të publikut dhe policisë ka ndryshuar gjatë periudhës kohore të vëzhguar. Kështu, mes viteve 2016 dhe 2020, te publiku ka pasur një rënie prej 3 of 3 pikë përqindje për pranisë së atyre që iu përgjigjën ‘Po’ pyetjes “A ka individë të korruptuar në Policinë e Shtetit?”. Megjithatë, perceptimi është rritur tek përfaqësuesit e policisë. Pjesa e të anketuarve të policisë që konfirmojnë se korrupsionin u rrit me 20 p.p. në vitin 2020 në krahasim me vitin 2016.


Është me rëndësi të theksohet se kjo rritje ndikohet edhe nga metodologjia e përdorur. Në vitin 2020, të anketuarit nuk e kishin opsionin për të refuzuar dhënien e përgjigjeve, ndërkohë që në 2016 ata kishin opsionin të mos përgjigjeshin, alternativë që u përzgjedh nga 34% e të anketuarve. (Shih Figurën 13).

Figura 13: Përqindja e të anketuarve që iu përgjigjën pyetjes: “A ka individë të korruptuar në Policinë e Shtetit?” (2014–2020, në %)



Publikut iu kërkua të tregonte sipas një shkalle perceptimin e tij për korrupsionin në mënyrë që të kuptohet më mirë situata duke e krahasuar këtë me raportimin e thjeshtë për një pyetje me përgjigje “Po” ose “Jo”. 70% e të anketuarve nga sondazhi publik raportuan se ata e perceptojnë korrupsionin në polici si shumë të përhapur ose shumë të përhapur dhe serioz, ndërkohë që vetëm një pakicë e të anketuarve (14%) mendojnë se korrupsioni në polici është me disa raste të izoluar ose nuk ekziston fare. Në përgjithësi, 17% e të anketuarve zgjedhën një përgjigje neutrale që tregon se ka korrupsion, por nuk është përhapur aq seriozisht. (Shih Figurën 14).


Figura 14: Perceptimi i publikut për nivelin e korrupsionit në polici në përgjithësi dhe sipas gradave (në %, N=1091)



U bënë përpjekje për të kuptuar nëse korrupsioni perceptohet si problem sistemi apo është një fenomen brenda strukturave të caktuara të Policisë së Shtetit. Si i tillë, publikut iu kërkua të identifikonte se si e perceptonin ata korrupsionin në nivele të ndryshme brenda strukturës së Policisë së Shtetit. Duket se ka pak ndryshime në perceptimin e korrupsionit sipas gradave në Policinë e Shtetit, duke konfirmuar se korrupsioni shihet më shumë si pjesë e sistemit. Korrupsioni raportohet veçanërisht si 'shumë i përhapur' dhe 'shumë i përhapur dhe serioz' mes oficerëve të rangut të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, me 64% të të anketuarve të sondazhit publik. Po ashtu, 56% e të anketuarve raportuan se korrupsioni është 'shumë i përhapur' dhe 'shumë i përhapur dhe serioz' mes oficerëve të rangut të lartë në Drejtorinë Rajonale të Policisë. Pjesa e atyre që e konsiderojnë korrupsionin si 'shumë të përhapur' / 'shumë të përhapur dhe serioz' mes oficerëve të rangut të mesëm në komisariate ose oficerëve të nivelit bazë në komisarariat be me gati 10 p.p., krahasuar me përhapjen e raportuar të korrupsionit mes oficerëve të rangut të lartë. Përqindja e raportimit nga publiku se korrupsioni mes drejtuesve të komisariateve është 'shumë i përhapur' / 'shumë i përhapur dhe serioz' ishte 61%. Kjo dukej se ishte më e perceptuar edhe në nivel qarku; krahasuar me 17% që thanë se korrupsioni ekziston por nuk është i përhapur seriozisht në strukturën e përgjithshme të policisë, kjo u rrit në 32% midis drejtuesve të rangut të lartë dhe oficerëve të policisë të nivelit të mesëm të drejtorisë rajonale sipas mendimit të publikut.


Megjithatë, perceptimi brenda Policisë së Shtetit për seriozitetin dhe përhapjen e korrupsionit brenda institucionit të policisë përsëri na jep një pamje të kundërt. Pjesa më e madhe e të anketuarve të policisë e raportuan korrupsionin si një fenomen që ekziston, por jo në nivel serioz (31% e të anketuarve), ose si të kufizuar në disa raste të izoluara (46%). Megjithatë, vetëm 9% e të anketuarve të policisë raportuan se korrupsioni nuk ekziston. Perceptimi se korrupsioni në polici nuk ekziston ishte shumë më i lartë kur bëhej fjalë për ndarjen sipas gradave dhe strukturave, por shpërndahej pothuajse në mënyrë të njëtrajtshme sipas nivele të ndryshme të gradave. Mes oficerëve të rangut të lartë perceptohet një nivel pak më i lartë korrupsioni nëse bëjmë krahasim me oficerët e rangut të mesëm dhe të ulët që punojnë në komisariate. (Shih Figurën 15).

Figura 15: Perceptimi i policisë për nivelin e korrupsionit në polici sipas gradave (në %, N=253)



Perceptimi për përhapjen dhe seriozitetin e korrupsionit në polici ka pësuar pak ndryshime me kalimin e kohës. Publiku i gjerë ka raportuar vazhdimisht se korrupsioni është shumë i përhapur, ndërsa policia beson se korrupsioni nuk është aq i përhapur ose, nëse ekziston, është i kufizuar në raste të izoluar. Përqindja e të anketuarve nga publiku që besojnë se korrupsioni është 'shumë i përhapur dhe serioz' / 'shumë i përhapur' është rritur nga 51% në 2014, në 68% në 2016, dhe 70% në 2020, me një rritje totale prej 36% midis 2020 dhe 2014. Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve nga policia që raportojnë se korrupsioni nuk është i përhapur ose, nëse ekziston, nuk është serioz është rritur me 10.9 p.p. ose është përmirësuar me 24% në 2020 krahasuar me vitin 2014. (Shih Figurën 16).


Figura 16: Perceptimi për nivelin e korrupsionit në polici siç raportohet nga sondazhi me publikun dhe me policinë 2014–2020



Përqindja e publikut që raportoi për korrupsion mes drejtuesve të rangjeve të larta në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit u rrit në vitin 2016 krahasuar me vitin 2014, por u ul në vitin 2020. Edhe përqindja e punonjësve të policisë që raportojnë se korrupsioni mes drejtuesve të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policia e Shtetit është “i përhapur dhe serioz” është rritur në vitin 2016 por që gjithsesi bie përsëri në 2020. Përqindja e të anketuarve nga publiku që raportojnë se korrupsioni është shumë i përhapur dhe serioz tek nivelet më të larta të drejtorive rajonale të Policisë së Shtetit, drejtuesve të komisariateve të policisë, si dhe tek oficerët me grada të nivelit të mesëm dhe operacional në drejtorinë rajonale të policisë u rritën vazhdimisht në vitet 2016 dhe 2020. Ndonëse korrupsioni në nivelin bazë të punonjësve të policisë në komisariate perceptohet ende si më pak i përhapur, përqindja e raportimit nga publiku se korrupsioni është ‘shumë i përhapur dhe serioz’ u rrit me 38% në 2020 krahasuar me vitin 2016.

Përqindja e të anketuarve në sondazhin e policisë që raportuan se korrupsioni është shumë i përhapur dhe serioz mes oficerëve të rangut të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorive të Policisë së Shtetit në nivel rajonal dhe nivelit bazë të oficerëve të policisë në komisariate u rrit në 2016 në krahasim me vitin 2014, por që ra në vitin 2020 krahasuar me 2016. Në sondazhin e vitit 2020 kemi një rritje të numrit të oficerëve të policisë që raportojnë se korrupsioni mes drejtuesve të komisariateve të policisë dhe niveleve të mesme dhe operationale në drejtoritë rajonale është shumë i përhapur dhe serioz. (Shih Figurën 17 dhe Shtojcën 2).

Figura 17: Ndryshimi në përqindjen e të anketuarve që mendojnë se korrupsioni është ‘shumë i përhapur dhe serioz’ sipas gradës, 2014–2020 (në %)




Publikut iu kërkua të raportonte edhe për perceptimin që kanë në lidhje me përhapjen e korrupsionit tek strukturat dhe drejtoritë e ndryshme të Policisë së Shtetit. Përqindja e raportimit të publikut se korrupsioni është ‘shumë i përhapur’ ose ‘shumë i përhapur dhe serioz’ ishte më e larta në Drejtorinë Antidrogës dhe Trafiqeve, Policinë Rrugore dhe Krimin Financiar, me përkatësisht 64%, 66% dhe 62%.¹² Nga të gjitha drejtoritë e Policisë së Shtetit, Patrulla e Përgjithshme dhe Drejtoria e Hetimit dhe Parandalimit të Krimin u raportuan se kishin përhapjen më të ulët të korrupsionit. Përqindja e të anketuarve që mendonin se korrupsioni në Patrullën e Përgjithshme nuk ekziston ose është minimal ishte 65%, dhe për Drejtorinë e Hetimit dhe Parandalimit të Krimin, 63%. Për sa i përket strukturave të tjera të Policisë së Shtetit, perceptimet e publikut u ndanë në mënyrë të barabartë, me



12 Kjo përfaqëson totalin e përgjigjeve që kanë zgjedhur si përgjigje ‘shumë i përhapur’ dhe ‘shumë i përhapur dhe serioz’.

thuaje të njëjtat shifra duke deklaruar se korrupsioni është ‘shumë i përhapur’ ose ‘shumë i përhapur dhe serioz’ si dhe ata që mendonin se korrupsioni nuk është i përhapur ose i përhapur, por jo në nivele serioze. Në total, 59% e të anketuarve nga publiku thanë se korrupsioni në Drejtorinë e Anti-korrupsion është ose shumë i përhapur/shumë i përhapur dhe serioz; ndërsa 56% e të anketuarve konsideronin Policinë e Kufirit dhe Migracionit me nivel korrupsioni të shumë përhapur dhe shumë të përhapur e serioz, dhe 51% që kishin të njëjtin perceptim për administratën e Policisë së Shtetit. Për departamentet e hetimit e krimit në komisariatet e policisë, 54% e përgjigjeve të publikut evidentonin se korrupsioni është shumë i përhapur / shumë i përhapur dhe serioz. (Shih Figurën 18).

Figura 18: Niveli i korrupsionit sipas strukturave të ndryshme të Policisë së Shtetit raportuar nga sondazhi me publikun (në %, N=1091)




Edhe të intervistuarit e sondazhit me policinë raportuan perceptimet e tyre se sa serioz dhe i përhapur është korrupsioni në struktura të ndryshme të Policisë së Shtetit. Oficerët e policisë të anketuar përgjithësisht e perceptojnë korrupsionin midis strukturave të Policisë së Shtetit ose jo ekzistues ose ekzistues, por vetëm në disa raste të izoluar. Përqindja e oficerëve të policisë që raportojnë se korrupsioni nuk ekziston ose ekziston vetëm në raste të izoluar varion nga 86% të raportuara për Patrullën e Përgjithshme, në 81% për administratën e Policisë së Shtetit, 76% për departamentin e hetimit të krimit në komisariat, në një minimum prej 59 % për Policinë Rrugore.

Për Policinë Rrugore dhe Policinë e Kufirit dhe Migracionit perceptohet një farë shkalle korrupsioni. Përqindja e të anketuarve që menduan se korrupsioni ishte mjaft i përhapur dhe i përhapur në Policinë Rrugore ishte 17%. Një nivel shumë i moderuar i korrupsionit raportohet edhe për Departamentin e Antikorrupsionit, Departamentin e Antidrogës dhe Trafiqueve si dhe për Departamentin e Krimin Financiar. Ndërkohë, përqindja e të anketuarve që e konsiderojnë korrupsionin si një fenomen që ekziston, por jo në nivel serioz ishte 18% si për Departamentin e Antikorrupsionit ashtu edhe për Departamentin e Antidrogës dhe Trafiqueve, dhe 22% për Departamentin kundër Krimin Financiar.

Strukturat më pak të korruptuara raportohet të jenë Patrulla e Përgjithshme, hetimi i krimin në komisariate ndjekur nga administrata e Policisë së Shtetit (12%). (Shih Figurën 19).

Figura 19: Perceptimi i policisë për përhapjen e korrupsionit sipas strukturave të ndryshme në Policisë e Shtetit (në %, N=253)




Korrupsioni i perceptuar nga struktura e Policisë së Shtetit ka ndryshuar gjatë periudhës 2014-2020. Perceptimi i publikut për përhapjen e korrupsionit është bërë edhe më i fortë me kalimin e kohës. Për Policinë e Trafikut, përqindja e publikut që e konsideronte korrupsionin si të përhapur u ul me 41% në 2016 në krahasim me vitin 2014, ndërkohë që u rrit me 11% në vitet 2016-2020. Rezultatet e sondazhit me policinë tregojnë se perceptimi i përhapjes së madhe të korrupsionit në Policinë Rrugore ra me 36% në 2016 krahasuar me vitin 2014 dhe përsëri me 23% në periudhën 2016-2020.

Përqindja e publikut që e konsideron korrupsionin si të përhapur në administratën e Policisë së Shtetit është rritur gjatë gjithë periudhës me një rritje prej 20% në 2016 krahasuar me 2014

dhe 42% në 2020 krahasuar me 2016. Perceptimi i publikut për përhapjen e korrupsionit në Departamentin e Antidrogës u rrit me 54% në 2016 krahasuar me 2014, por u ul me 11% në 2020 krahasuar me 2016. Perceptimi i oficerëve të policisë, nga ana tjetër, i përhapjes së korrupsionit në Departamentin e Antidrogës është ulur ndjeshëm, pasi përqindja e atyre që konfirmojnë se korrupsioni është i përhapur ra me 17% në 2016 krahasuar me 2014 dhe me 58% në 2020 krahasuar me 2016.

Si publiku ashtu edhe policia shohin se janë rritur përqindjet e të anketuarve të tyre që e konsiderojnë korrupsionin si të përhapur në Policinë e Kufirit dhe Migracionit dhe në Departamentin e Krimit të Rëndë në periudhën 2016-2020. Kjo rritje është më e madhe për policinë sesa për publikun, me 53% që janë në sondazhin me policinë krahasuar me 29% në atë të publikut në lidhje me Policinë e Kufirit dhe Migracionit, dhe 43% të policisë krahasuar me 22% në publikun për Departamentin e Krimit të Rëndë. (Shih Figurën 20).

Figura 20: Ndryshimi në përqindjen e perceptimeve të publikut dhe policisë për përhapjen e korrupsionit sipas strukturave të Policisë së Shtetit, 2014–2020 (në %)



Në sondazh u përfshinë edhe një sërë pohimesh të përcaktuara për korrupsionin për t'u krahasuar me përgjigjet e dhëna në pyetjet e hapura për këtë temë. Në ndryshim nga pyetjet e hapura, kur i përgjigjen pohimeve, përqindja e individëve që perceptojnë se ka korrupsion në Policinë e Shtetit ka rënë. Vetëm 22.3% e individëve të anketuar nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me pohimin: “Në radhët e Policisë së Shtetit ka mjaft punonjës të pakorruptuar”, gjë që do të tregonte një perceptim të korrupsionit mes punonjësve të policisë. Një tjetër 30% e të anketuarve nuk kishin dëshirë t'i përgjigjeshin duke zgjedhur as të ishin dakord as të mos ishin dakord me pohimin. Një përqindje prej 48.8% e të anketuarve janë dakord me pohimin.


Edhe për pohimin “Shumica e punonjësve në Policinë e Shtetit janë të motivuar për zbatimin e ligjit” kemi të njëjtin stil përgjigjesh; 36% e publikut janë dakord me pohimin dhe 30.2% nuk janë dakord ose aspak dakord me këtë pohim. Përqindja e atyre që nuk duan t'i përgjigjen kësaj pyetje është ende e konsiderueshme, me 34% të të anketuarve.

Pozicioni i publikut është i paqartë për sa i përket pohimit se “Institucioni i “Policisë së Shtetit” nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij”. Përqindja e atyre që janë dakord, që nuk janë dakord ose që nuk duan të përgjigjen është pothuajse e barabartë. 36% e të anketuarve mendojnë se korrupsioni është kryesisht sjellje individuale, ndërsa 34.1% mendojnë se korrupsioni është pjesë e sistemit dhe jo sjellje individuale.

Të anketuarit në sondazhin publik që nuk janë dakord/aspak dakord me pohimi “Punonjësit e Policisë së Shtetit janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e policisë”, përbënin 43.1% të totalit të përgjigjeve. gjithsesi, 29.4% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord se punonjësit e policisë janë korruptuar para se të hyjnë në radhët e Policisë së Shtetit.

Publikut iu kërkua t'i përgjigjej edhe pohimeve të ndryshme në lidhje me korrupsionin në polici sipas viteve të përvojës, gjinisë së punonjësve të policisë si dhe llojit të shërbimit dhe gradës së tyre. 49.4% e individëve të anketuar janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin se “Punonjësit e Policisë së Shtetit me më shumë vite eksperiencë pune në Policinë e Shtetit janë më të korruptuar sesa punonjësit e rinj”; 52.5% e të anketuarve janë dakord/plotësisht dakord me pohimin se “Punonjësit meshkuj të Policisë e Shtetit janë më të korruptuar sesa ato femra”. Për më tepër, 43.7% e të anketuarve janë punëdhënësi/plotësisht dakord me pohimin “Punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyra”. Së fundmi, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (59.9%) janë dakord/plotësisht dakord me pohimin se “Punonjësit në Policinë e Shtetit në nivelet e larta drejtuese janë më pak të korruptuar se policët e nivelit bazë të policisë”, gjë që tregon se korrupsioni konsiderohet në nivel më të ulët tek oficerët me grada të larta në Policinë e Shtetit. (Shih Figurën 21).


Figura 21: Përqindja e të anketuarve nga publiku që janë dakord dhe nuk janë dakord me pohimet që përshkruajnë korrupsionin në Policinë e Shtetit (në %, N=1091)



Mes punonjësve të anketuar të policisë, 73% janë plotësisht dakord ose dakord me pohimin se “Shumica e punonjësve në Policinë e Shtetit janë të motivuar për zbatimin e ligjit”. Korrupsioni përgjithësisht perceptohet si sjellje individuale dhe jo pjesë e sistemit; 66% e të anketuarve të policisë janë dakord me pohimin se “Institucioni i “Policisë së Shtetit” nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij”. 53% e policëve të anketuar janë dakord me pohimin se “Në radhët e Policisë së Shtetit ka mjaft punonjës të pakorruptuar”. Për më tepër, 69% e të anketuarve të policisë nuk janë dakord ose aspak dakord me pohimin se “Punonjësit e Policisë së Shtetit janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e policisë”.

Sondazhi i policisë është në kontrast me perceptimin e publikut për sa i përket profilizimit demografik të korrupsionit; identifikimin e punonjësve femra të policisë, të rinjtë, punonjësit e zyrës dhe ata të nivelit bazë, si më të korruptuar se sa meshkuj, ata me përvojë, specialistët e terrenit dhe ata të rangut të lartë. Përqindja e punonjësve të policisë që nuk janë aspak dakord dhe nuk janë dakord me pohimin se oficerët meshkuj janë më të korruptuar sesa oficeret femra ishte 59%. Ata që nuk janë aspak dakord dhe nuk janë dakord me pohimin se oficerët që punojnë në terren janë më të korruptuar sesa ata që punojnë në zyrë ishin 61% e kampionit, ndërsa 65% e të anketuarve nuk ishin dakord me pohimin se oficerët e policisë me përvojë janë më të korruptuar sesa oficerët e rinj.

Figura 22: Përqindja e të anketuarve nga policia që janë dakord dhe nuk janë dakord me pohimet që përshkruajnë korrupsionin në Policinë e Shtetit (në %, N=253)




Dakordësia e publikut me pohimin se “Punonjësit e Policisë së Shtetit janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e policisë” ka rënë me kalimin e kohës, me 84% në vitin 2016 krahasuar me 2014, me me 33% në 2020 krahasuar me vitin 2016. Kjo tregon se publiku beson se korrupsioni zhvillohet brenda institucionit. E kundërta është e vërtetë për të anketuarit nga policia teksa përqindja e atyre që janë dakord me pohimin se “Punonjësit e Policisë së Shtetit janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e policisë” është rritur me kalimin e viteve.

Përqindja e publikut që është dakord me pohimin se korrupsioni në polici është sjellje individuale dhe jo pjesë e sistemit ka rënë në vitin 2016 krahasuar me 2014 dhe në vitin 2020 krahasuar me 2016. Megjithatë, ka pasur një rënie të madhe në përqindjen e të anketuarve nga publiku që janë dakord me këtë pohim në 2020, duke rënë me 58% që nga viti 2016, krahasuar me një rënie prej 3% nga 2014 në 2016. Përqindja e të anketuarve nga policia që janë dakord me pohimin “Institucioni i “Policisë së Shtetit” nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij” është rritur me 39% në 2020 krahasuar me 2016 .

Kur bëhet fjalë për profilet demografike, përqindja e publikut dhe policisë që janë dakord se punonjësit meshkuj të policisë janë më të korruptuar se femrat ka rënë gjatë viteve, për publikun me 51% dhe për policinë me 10% (në 2020 krahasuar me 2016). Përqindja e të anketuarve nga publiku që janë dakord me pohimin se punonjësit e Policisë së Shtetit

që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyra ka rënë për të dytën herë radhazi (2016 dhe 2020). Si për krahasim, përqindja e të anketuarve në polici u rrit në vitin 2016 krahasuar me 2014 dhe në 2020 krahasuar me 2016 me 20% dhe 3% përkatësisht.

Figura 23: Ndryshimi në përqindjen e të anketuarve nga publiku dhe policia që janë dakord me pohimet për korrupsionin 2014–2020 (në %)



Përqindja e publikut që janë dakord me pohimin “Shumica e punonjësve në Policinë e Shtetit janë të motivuar për zbatimin e ligjit” ka rënë ndjeshëm në vitin 2020 në krahasim me 2016 dhe një nga tre të anketuar nuk janë dakord me pohimin. Përqindja e të anketuarve nga policia që janë dakord me pohimin nuk ka ndryshuar gjatë këtyre viteve. (Shih Figurën 23).

V. KORRUPSIONI SIÇ PËRJETOHET NGA PUBLIKU DHE POLICIA

Pikat kryesore


- Perceptimi për korrupsionin shpesh bazohet në përvojë. Një në tre qytetarë që raportuan se kishin ndërvepruar me policinë deklaruan se ose ai/ajo kishte ofruar ose u ishte kërkuar ryshfet. 27% e të anketuarve që deklaruan se kishin ndërvepruar me një punonjës policie në 12 muajt e fundit raportuan se i kishin ofruar ryshfet policisë, ndërsa 34% e të anketuarve nga publiku thanë se u ishte kërkuar të paguanin ryshfet.
- Për sa i përket departamenteve, përqindja më e madhe e të anketuarve që konfirmuan se i kishin ofruar ryshfet punonjësve të policisë i referohej Departament të Krimin Financiar. Një në dy qytetarë raportuan që i kishin ofruar ryshfet punonjësve të policisë nga ky departament.
- Edhe Policia e Kufirit dhe Migracionit si dhe Policia Rrugore morën përqindje të larta në lidhje me ryshfetin. Rreth një në tre të anketuar që kanë pasur kontakte me këto struktura u ishte kërkuar të jepnin ryshfet.
- Nivel i moderuar korrupsioni raportohet edhe për strukturat e policisë si punonjësit e policisë në komunitetit, administrata e Policisë së Shtetit dhe Departamenti i Hetimit dhe Parandalimit të Krimin. Disa nga strukturat e Policisë së Shtetit me një përhapje më të ulët të ryshfetit janë Patrulla e Përgjithshme dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA).
- Një në dy qytetarë që kanë pasur kontakt me Policinë e Shtetit thanë se e dinin se ku të denonconin korrupsionin. Megjithatë, 43% e atyre që ishin përballur me praktika korruptive nuk dinin se ku ta denonconin korrupsionin.
- Vetëm 6% e individëve të intervistuar u përgjigjën se kanë denoncuar një akt korrupsioni nga një punonjës policie. Arsye që kanë penguar denoncimin e korrupsionit kanë qenë edhe mungesa e informacionit se ku mund të denoncojnë korrupsionin ose ideja se denoncimi i korrupsionit kërkon shumë kohë.
- 5% e publikut nuk e raportoi korrupsionin, sepse ndjeheshin të kërcënuar nëse do të denonconin korrupsionin në polici.
- Sondazhi me publikun tregon se mjetet e rëndësishme që mbështesin denoncimin e korrupsionit janë aplikacioni i Policisë së Shtetit (Komisariati Dixhital), i përdorur nga 28% e të anketuarve, dhe numri i gjelbër i SHÇBA, i përdorur nga 13% e të anketuarve. 46% e denoncimeve të korrupsionit kanë ndjekur procedurën zyrtare nëpërmjet Prokurorisë apo Komisariatit të Policisë.

V.1 Korrupsioni siç përjetohet nga publiku i përgjithshëm

Në këtë pjesë të sondazhit synohet të zërthehet korrupsioni siç përjetohet dhe përballet nga publiku. Kjo është një pyetje e ndjeshme dhe njerëzit shpesh hezitojnë t'i japin përgjigje. Megjithatë, duke kombinuar perceptimin me përvojën aktuale, mund të jemi në gjendje të japim një vlerësim më të mirë të realitetit të integritetit dhe korrupsionit në Policinë e Shtetit. Si rrjedhojë, të intervistuarve nga sondazhi me publikun iu kërkua të identifikonin nëse në 12 muajt e fundit kishin pasur kontakt apo ndërvepruar me policinë dhe ndonjë prej departamenteve ose shërbimeve të ofruara.


Në përgjithësi, 76% e të anketuarve deklaruan se kishin pasur kontakt me policinë në 12 muajt e fundit. Të anketuarit meshkuj raportuan më shpesh kontakte me policinë (82% krahasuar me 70% të femrave). Edhe të anketuarit nga zonat urbane kishin një prirje më të lartë për të ndërvepruar me Policinë e Shtetit (80% krahasuar me 70% të njerëzve që banojnë në zonat rurale). 68% e të anketuarve të grupmoshës 18-25 vjeç thanë se kishin ndërvepruar me policinë vitin e fundit. Grupmoshat me përqindjen më të lartë që kanë pasur kontakte me Policinë e Shtetit janë 26–35 vjeç dhe 36–45 vjeç. Numri i të intervistuarve në marrëdhënie pune që kishin ndërvepruar me policinë në 12 muajt e fundit është më i lartë se ata të papunë, veçanërisht ata të punësuar në sektorin publik me 86% që deklaruan se kishin kontaktuar me policinë në 12 muajt e fundit. Po ashtu, edhe individët me arsim të lartë dhe ata me të ardhura mesatare dhe të mëdha kanë një frekuencë të lartë ndërveprimi me Policinë e Shtetit. (Shih Figurën 24).

Figura 24: Përqindja e të anketuarve që deklarojnë se kanë pasur kontakt me policinë në 12 muajt e fundit (në %, N=1091)



Struktura e Policisë së Shtetit me të cilën publiku kishte më shumë kontakt ishte Policia Rrugore, me 43% të të anketuarve që raportuan një gjë të tillë. Departamentet e tjera të Policisë së Shtetit që kishin pasur kontakt me publikun në 12 muajt e fundit ishin Patrulla e Përgjithshme (36% e të anketuarve) dhe oficerët e policisë në komunitet (17%). Nga ana tjetër, publiku raportoi se kishte pasur ndërveprim të moderuar me Departamentin e Antidrogës dhe Trafiqueve, Policinë e Kufirit dhe Migracionit, administratën e Policisë së Shtetit dhe SHÇBA. Drejtoritë e policisë që kishin më pak kontakt me publikun ishin Departamenti i Krimit Financiar, Departamenti i Hetimit dhe Parandalimit të Krimit dhe Departamenti Antikorrupsion; vetëm 3% e të anketuarve raportuan se kishin pasur kontakte me këto struktura në 12 muajt e fundit. (Shih Figurën 25).

Figura 25: Përqindja e publikut që deklaroi se kishte pasur kontakt me punonjës të policisë në 12 muajt e fundit, sipas strukturave të ndryshme (në %, N=1097)



Të anketuarve nga publiku iu kërkua të raportnin edhe nëse gjatë kontaktit që kishin me policinë në 12 muajt e fundit kishin tentuar t'u jepnin ryshfet një oficeri policie apo nëse u ishte kërkuar shprehimisht të jepnin një ryshfet, dhuratë ose favor tjetër. Përqindja totale e individëve që thonë se kanë ofruar ryshfet ose u është kërkuar ryshfet vlerësohet duke përdorur numrin e të anketuarve që kanë deklaruar se kishin kontakte me Policinë e Shtetit ose me strukturat e saj.


27% e të anketuarve që kanë pasur kontakte me Policinë e Shtetit në 12 muajt e fundit thanë se u kishin ofruar ryshfet oficerëve të policisë. Përqindja e të anketuarve që konfirmojnë se u është kërkuar ryshfet ishte 34%, ose 7 p.p. më e lartë se përqindja e individëve që raportuan se kishin ofruar ryshfet me vullnetin e tyre.

Përhapja e korrupsionit sipas përvojës së të anketuarve nga publiku ndryshon ndjeshëm sipas strukturës apo departamentit të Policisë së Shtetit. Përqindja më e lartë e të anketuarve që konfirmojnë se i kishin ofruar ryshfet një oficeri policie (50%) u raportua për departamentin e Krimit Financiar, ku 42% e tyre u ishte kërkuar të jepnin ryshfet. Edhe Policia e Kufirit dhe Migracionit dhe Policia e Rrugore kishin përqindje të lartë për sa i përket ryshfetit, me 37% të të anketuarve që i kishin dhënë ryshfet policisë së kufirit, ndërkohë që 35% e të anketuarve thanë se u ishte kërkuar ryshfet. Për Policinë Rrugore, 34% e të anketuarve raportohet se kishin ofruar ryshfet dhe pak më shumë të anketuar (39%) u ishte kërkuar ryshfet.

Nivel i moderuar korrupsioni raportohet edhe policëve që punojnë në komunitet, në administratën e Policisë së Shtetit dhe në Departamentin e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit. 13% e të anketuarve deklaruan se u kishin ofruar ryshfet oficerëve të policisë në komunitet dhe se u ishte kërkuar një gjë e tillë. Ndërsa, 21% e të anketuarve thanë se u ishte kërkuar ryshfet nga një punonjës i administratës së Policisë së Shtetit dhe 20% e të anketuarve deklaruan se një oficer i Departamentit të Hetimit dhe Parandalimit të Krimit u kishte kërkuar ryshfet.

Strukturat e Policisë së Shtetit me përhapjen më të ulët të raportuar të korrupsionit janë Patrulla e Përgjithshme e, Departamenti i Antidrogës dhe Trafiqueve dhe SHÇBA - me jo më shumë se maksimumi 5-6% e të anketuarve që raportojnë fenomenin e ryshfetit gjatë kontaktit me ndonjë prej këtyre departamenteve. (Shih Figurën 26).

Figura 26: Të anketuarit nga publik që u është kërkuar shprehimisht ryshfet nga punonjësi i policisë në 12 muajt e fundit, kundrejt ofrimit të ryshfetit një punonjësi policie në 12 muajt e fundit (në%)




Nuk ishte e mundur të bënim një krahasim të plotë të raportimit nga të anketuar të publikut që u ishte kërkuar ose kishin ofruar ryshfet gjatë këtyre viteve, duke qenë se struktura e Policisë së Shtetit ka ndryshuar. Megjithatë, për ato struktura që kanë mbetur të njëjta, kemi krahasuar dinamikën e tendencës për ryshfet. Në përgjithësi, ryshfeti (i kërkuar ose i ofruar) kishte një dinamikë në formë U, me një rënie në 2016 dhe rritje në 2020 krahasuar me 2016 dhe 2014. Ky trend është më i theksuar për Policinë Rrugore dhe administratën e Policisë së Shtetit; ndërsa ka pasur një rritje të lehtë të shumicës së të anketuarve nga publiku që u ishte kërkuar ryshfet nga Departamenti i Hetimit të Krimeve dhe SHÇBA. (Shih Tabelë 2)

Tabela 2: Shpeshësia e kërkesës dhe ofrimit të ryshfetit te një punonjës policie, 2014–2020 (në %)

	Punonjësi i policisë kërkoi ryshfet			I ofrova ryshfet punonjësit të policisë		
	2014	2016	2020	2014	2016	2020
Policia Rrugore	21%	18%	28.2%	23%	17%	36.9%
Antidroga dhe Trafiqet	2%	1%	0.5%	1%	1%	0.8%
Kufiri dhe Migracioni	4%	2%	0.7%	3%	1%	3%
Hetimi i Krimit	0%	0%	0.7%	0.5%	0%	1%
SHÇBA	0%	0%	0.5%	0.5%	1%	0%
Administrata e Policisë së Shtetit	1%	1%	1.8%	1%	0%	2.4%


Të anketuarve nga publiku që u është kërkuar apo kanë ofruar ryshfet te punonjësit e policisë iu kërkuar të përshkruanin reagimin e punonjësve të policisë. Të anketuarve iu kërkuar të deklaronin nëse punonjësit e policisë e refuzuan apo e pranorin ryshfetin. Nga të gjithë të anketuarit që kanë ofruar një ryshfet, 86% thanë që punonjësi e pranoi atë. Vetëm 9% e të anketuarve raportuan se punonjësi i policisë e refuzoi ryshfetin e ofruar, ndërsa 6% e të intervistuarve refuzuan të përgjigjen. Sipas përgjigjeve, mospranimi i ryshfetit ishte pak më i zakonshëm në zonat rurale dhe mes të anketuarve meshkuj (edhe pse një përqindje shumë më e lartë e të anketuarve femra refuzuan të përgjigjeshin). Po ashtu, shkalla e refuzimit ishte më e lartë te të anketuarit e grupmoshës 46-65 vjeç krahasuar me grupmoshat më të reja. (Shih Figurën 27).

Figura 27: Reagimi i punonjësit të policisë kur i është ofruar rryshfet, sipas të intervistuarve nga publiku (në %)



Niveli i ndërgjegjësimit dhe informacionit se ku mund të denoncojnë rastet e korrupsionit me të cilat përballen gjatë kontaktit me Policinë e Shtetit është i moderuar. Vetëm 57% e të anketuarve që kishin hasur praktika korruptive (N = 276) u përgjigjën se dinë ku të denoncojnë korrupsionin, duke rezultuar se 43% nuk e dinin se ku të denonconin praktikatat korruptive. Femrat duket se kanë një nivel më të ulët ndërgjegjësimit për sa i përket se ku duhet të denoncojnë korrupsionin, me 53% të tyre krahasuar me 37% të meshkujve të anketuar. Nga ana tjetër, edhe tek individët e grupmoshës 46-55 vjeç dhe tek ata me të ardhura të ulëta u evidentua një ndërgjegjësimit më i ulët krahasuar me grupmoshat e tjera dhe ato me të ardhura më të larta, ndërkohë që nuk ndryshonin shumë nga tendenca e përgjithshme. (Shih Figurën 28).

Figura 28: Përqindja e të anketuarve nga publiku që dinë se ku të denoncojnë praktikat korruptive (në %, N=276)



Përqindja e denoncimit të praktikave korruptive nga popullata është shumë e ulët, po të kemi parasysh se vetëm 6% e individëve të intervistuar u përgjigjën se kanë denoncuar një vepër korrupsioni të kryer nga një oficer i Policisë së Shtetit. Të anketuarit meshkuj raportuan një përqindje pak më të lartë denoncimi të korrupsionit në krahasim me femrat (7% krahasuar me 5%), përqindje që gjithsesi është e ulët. Të anketuarit nga zonat urbane prirën më shumë për të raportuar korrupsionin sesa popullsia në përgjithësi dhe janë dyfishi i përqindjes së zonave rurale (8% në zonat urbane, krahasuar me 4% në zonat rurale). Individët e moshës 56-65 vjeç kanë përqindjen më të lartë të denoncimi të korrupsionit (9% krahasuar me 6% në përgjithësi). Të anketuarit e punësuar në sektorin privat si dhe ata me të ardhura të larta kanë, po ashtu, një përqindje pak më të lartë të raportimit të korrupsionit sesa niveli në përgjithësi për sondazhin me publikun (10% krahasuar me 6%), ndërkohë që 15% e të punësuarve në sektorin publik deklarojnë se kanë denoncuar

korrupsion, përqindje që më shumë se dyfishi i nivelit të përgjithshëm të raportuar nga sondazhi. (Shih Figurën 29).

Një përqindje e madhe e publikut konfirmojnë se kurrë nuk i kanë denoncuar praktikat korruptive, gjë që konfirmohet nga niveli prej 94% i kampionit të përgjithshëm të të anketuarve. Kur u pyetën për arsyet e mosdenoncimit, 58% u përgjigjën se nuk janë përballur kurrë me një situatë ku korrupsioni bëhen nga punonjësit e policisë dhe një tjetër 8% e individëve të anketuar zgjodhën të mos i përgjigjen kësaj pyetje.

Disa nga arsyet e tjera që dhanë si përgjigje të anketuarit për pyetjen pse nuk i denoncin praktikat korruptive, 16.5% thanë se me rryshfet e kishin më të lehtë për të zgjidhur problemin e tyre. 8% e të anketuarve deklaruan se nuk kishin informacion se ku të denoncin praktikat korruptive, ndërsa 4% e individëve të intervistuar mendojnë se denoncimi i korrupsionit kërkon shumë kohë. Një pjesë e vogël e të intervistuarve (5%) nuk e kishin denoncuar korrupsionin pasi kishin frikë nga pasojat. Ndër arsyet e shprehura në kategorinë “arsye tjetër”, ishte mungesa e motivimit tek publiku për të denoncuar korrupsionin. Shumë besojnë se kjo mund të shkaktojë probleme për ta, pasi do të identifikoheshin lehtësisht nga punonjësi i policisë për të cilin kishin bërë denoncim, ndërsa disa thanë se nuk prisnin që të ndryshonte ndonjë gjë pas denoncimit të korrupsionit. (Shih Figurat 29 dhe 30).

Figura 29: Shpeshësia e denoncimit nga publiku të rryshfetit (apo tentativës për rryshfet) nga një punonjësi i Policisë së Shtetit (në %, N=1091)





Figura 30: Arsyet kryesore pse nuk denoncohet korrupsioni (në %, N=1099)

Mes të anketuarve që deklaruan se kishin denoncuar korrupsionin, 28% kishin përdorur aplikacionin e Policisë së Shtetit (Komisariati Dixhital) për denoncimin e korrupsionit. 26% e denoncuan korrupsionin në Prokurori dhe 20% të rasteve u denoncuan në komisariatit e policisë. Një rol të rëndësishëm në denoncimin e korrupsionit ka luajtur numri i gjelbër i SHÇBA, numër që është përdorur në 13% të raportimit të korrupsionit.

Gjatë këtyre viteve, pranimi i ryshfeteve ka pasur një dinamikë në formë të përmbytur U-je, duke u rritur në 2016 krahasuar me 2014 dhe më pas pak duke u ulur me 3.5 pikë përqindje në 2020 krahasuar me 2016. Një faktor kontribuues për këtë duket se është fakti i rritjes së përqindjes së të anketuarve që refuzojnë t'i përgjigjen, përqindje që u rrit në vitin 2020. Edhe përqindja e individëve që dinë se ku të denoncojnë korrupsionin ndjek një formë U të përmbytur, me një rritje në 2016 krahasuar me 2014 dhe një rënie në 2020 krahasuar me 2016. Për më tepër, në 2020 është rritur me 2.4 p.p. krahasuar me vitin 2016 përqindja e të anketuarve që kanë denoncuar praktikatat korruptive.

Për t'u kthyer tek arsyet e publikut se përse nuk kishin denoncuar raste të praktikave korruptive: përqindja e atyre që thonë se nuk ishin ndeshur asnjëherë me korrupsionin u rrit me rreth 1 pikë përqindje në secilin raund. Ka pasur një rritje të konsiderueshme edhe në përqindjen e të anketuarve që deklarojnë se nuk kanë denoncuar korrupsionin, sepse donin ta zgjidhnin problemin e tyre në mënyrë tjetër edhe nëse përmes praktikave korruptive (2016 krahasuar me 2014 kishte një rritje prej 3 pikë përqindje, dhe më tej 2.9 p.p. rritje 2020 krahasuar me vitin 2016).


Tabela 3: Informimi i publikut për denoncimin e korrupsionit, 2014–2020 (në %)

Nëse gjatë vitit të fundit keni dhënë ryshfet, dhuratë ose favor për ndonjë nga punonjësit e strukturave të policisë, cili ka qenë reagimi i tyre?	2014	2016	2020
E ka pranuar ryshfetin /dhuratën/favorin	86%	89%	85.5%
Nuk e ka pranuar ryshfetin /dhuratën/ favorin	14%	11%	8.6%
Nuk e di/refuzoj të përgjigjem	0%	0%	5.9%
A e dini se ku mund të denonconi një akt (ose tentativë) korrupsioni nga një punonjës i Policisë së Shtetit?	Publik 2014	Publik 2016	Publik 2020
Po	55%	65%	57.5%
Jo	45%	35%	42.5%
A keni denoncuar ndonjëherë një akt (ose tentativë) korrupsioni nga një punonjës i Policisë së Shtetit?	Publik 2014	Publik 2016	Publik 2020
Po	5%	5%	6.4%
Jo	91%	95%	93.6%
Nuk e di/refuzoj të përgjigjem	4%	0%	8.2%
Cila ka qenë arsyeja e mosdenoncimit?	2014	2016	2020
Nuk jam ndeshur asnjëherë me një akt korrupsioni nga punonjësit e policisë	56%	57%	58.1%
Nuk kam pasur kohë, kam qenë me nxitim	3%	5%	4.5%
Nuk kam pasur informacion/nuk e dija se ku mund të denoncoja	6%	7%	8.5%
Ka qenë më e lehtë të zgjidh problemin me anë të praktikave korruptive	9%	12%	14.9%
Kam pasur frikë nga pasojat	12%	19%	0.2%
Tjetër	2%	0%	0.2%
Refuzoj të përgjigjem	12%	0%	8.2%

V.2 Korrupsioni siç përjetohet nga të anketuarit e policisë

Sondazhi me punonjësit e policisë kishte për qëllim të kuptonte nëse dhe sa shpesh punonjësit e policisë përballen me praktika korruptive, të ndikuar nga qytetarët, kolegët ose eprorët/drejtuuesit e tyre. Në përgjithësi, përqindja e oficerëve të policisë që thanë se janë ndeshur me një situatë me natyrë korrupsioni është e ulët. Raportohen se ka raste korrupsioni që ndodhin një herë ose herë pas here. Megjithatë, punonjësit e policisë në një shumicë dërrmuese u përgjigjën se nuk janë përballur kurrë me raste korrupsioni: 70% e policëve të anketuar u përgjigjën se nuk u është ofruar asnjëherë rryshfet nga qytetarët, 78% e të anketuarve raportuan se nuk u ishte dhënë asnjëherë rryshfet apo favor nga qytetarët, 50 % raportuan se qytetarët nuk u kanë kërkuar kurrë ndonjë favor dhe 60% thanë kolegët nuk u kanë kërkuar asnjëherë ndonjë favor. Nëse mbledhim të gjitha përgjigjet e tjera (ndodh të paktën një herë, ndonjëherë, shpesh ose shumë shpesh), atëherë përqindja mesatare e oficerëve të policisë që kanë përjetuar një situatë korruptive është 30%, ku përgjigja “një koleg më ka kërkuar favore” ishte forma më i zakonshme e korrupsionit të raportuar nga punonjësit e policisë.


Figura 31: Sa shpesh përjetojnë praktika korruptive punonjësit e policisë (në %, N=253)



Sipas përgjigjeve të punonjësve të policisë, shumica kurrë nuk kishin asnjë kërkesë (68%) apo presion (79%) nga eprorët e tyre për të fshehur ose mos proceduar një rast shkeljeje të ligjit. Pjesa më e madhe e punonjësve të policisë thanë se nuk kishin denoncuar kurrë një rast korrupsioni nga kolegët e tyre (95%), nga eprorët e tyre (96%) ose nga një qytetar (84%). Vetëm 5% e oficerëve të anketuar thanë se kishin denoncuar korrupsion në media (një herë/ndonjëherë). (Shih Figurën 31)

Punonjësve të policisë iu kërkua të raportonin nëse kishin qenë dëshmitarë të praktikave korruptive, sesa të përballëshin me to. 86% e të anketuarve deklarojnë se kurrë nuk kanë qenë dëshmitarë të një rasti kur një koleg tjetër oficer policie të ketë marrë ryshfet apo favore ose të ketë kërkuar ryshfet ose favore nga një qytetar. 76% e të anketuarve raportuan se nuk kishin qenë kurrë dëshmitarë ku një punonjës policie t'i ketë ofruar favore qytetarëve dhe 66% thanë se nuk kishin qenë asnjëherë dëshmitarë ku një punonjës policie të merrte favore nga një koleg. 91% e oficerëve të policisë të anketuar nuk kanë qenë kurrë dëshmitarë ku një punonjës policie të ketë ngritur denoncuar një rast korrupsioni të një kolegu apo eprorëve të tij/saj. Si për krahasim, 30% e punonjësve të policisë raportuan se kishin qenë dëshmitarë ku një punonjës policie bënte një ankesë për praktikat korruptive të qytetarëve. (Shih Figurën 32)

Figura 32: Sa shpesh punonjës të policisë bëhen dëshmitarë të praktikave korruptive (në %, N=253)



VI. TIPOLOGJIA DHE PËRHAPJA E PRAKTIKAVE KORRUPTIVE

Pikat kryesore

- Siç e kemi theksuar tashmë, 70% e punonjësve të policisë u përgjigjën se nuk u ishte ofruar kurrë ryshfet nga qytetarët dhe 78% e të anketuarve në polici thanë se nuk u ishte bërë asnjëherë ndonjë favor nga qytetarët. Një përqindje edhe më e lartë e policëve të intervistuar thanë se nuk kishin qenë kurrë dëshmitarë të dhënies së ndonjë ryshfeti apo favorit.
- Oficerët e policisë raportuan në përgjithësi se nuk kishin marrë asnjëherë ndonjë kërkesë apo t'u ishte bërë presion nga eprorët e tyre për të fshehur ose mos proceduar një rast të shkeljes së ligjit, me 69% dhe 79% përkatësisht që raportuan këtë. Po ashtu, ata deklaruan se nuk kishin raportuar pothuajse kurrë një rast korrupsioni të një kolegu, të eprorëve apo të një qytetari.
- Më shumë se 60% e të anketuarve nga sondazhi publik thanë se ryshfeti dhe favorizimet janë formë korrupsioni që ndodh shpesh/shumë shpesh. Një në dy qytetarë besonte se korrupsioni shfaqet shpesh/shumë shpesh si shpërdorim/abuzim i fondeve dhe pasurive të Policisë së Shtetit. Në një përqindje të ngjashme, publiku mendonte se korrupsioni është shpesh/shumë shpesh arsyeja që punonjësit e policisë fshehin/manipulojnë provat ose përdorin forcë të tepruar.
- E kundërta raportohet nga sondazhi me policinë, ku aktet korruptive, si ryshfeti, favoret, shpërdorimi i fondeve dhe pasurive publike, abuzimi me pushtetin apo manipulimi i provave, raportohen si dukuri që nuk ndodhin fare ose shumë rrallë.
- 57% e të anketuarve nga publiku ishin dakord se punonjësit e policisë kanë lidhje me njerëz nga bota e krimit, përfshirë krimin e organizuar. Për më tepër, 61% e të anketuarve në sondazhin publik u shprehën dakord/plotësisht dakord se oficerët e policisë janë të përfshirë në aktivitete të paligjshme.
- Një në çdo dy qytetarë nuk ishte dakord me idenë se rekrutimi dhe ngritja në detyrë në Policinë e Shtetit bazohet në meritokraci. Një përqindje e ngjashme e publikut mendonte se Policia e Shtetit përdoret nga drejtuesit për përfitime politike. Nga ana tjetër, publiku perceptoi mungesën e unitetit dhe bashkëpunimit mes policisë në luftën kundër korrupsionit (63% e të anketuarve).
- Ndërkohë, rreth 55% e punonjësve të anketuar të policisë besojnë se punonjësit kanë lidhje me botën e krimit dhe në përfshirjen e policëve në aktivitet të paligjshme.


- Opinioni i të anketuarve nga policia për praktikat e rekrutimit dhe ngritjes në detyrë në radhët e Policisë së Shtetit nuk ishte shumë i qartë, ku kemi një përqindje pothuajse të barabartë mes atyre që nuk janë dakord dhe atyre që janë dakord se rekrutimi dhe ngritja në detyrë bazohet në meritokraci.
- Në kontrast me atë që mendon publiku, të anketuarit nga policia besojnë se ekziston një bashkëpunim më i mirë mes punonjësve të policisë dhe eprorëve të tyre në luftën kundër korrupsionit dhe krimit, po të kemi parasysh se 65% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim.

VI.1 Tipologjia e korrupsionit dhe shpeshësia e akteve korruptive siç raportohet nga sondazhi me publikun dhe policinë


Në të dy sondazhet me publikun dhe policinë u evidentuan tre lloje praktikash korruptive si më të shpeshat: ryshfeti, favorët ndaj kolegëve dhe favorët që oficerët e policisë bëjnë për palë të treta.

Plot 69% e të anketuarve nga sondazhi publik thanë se ryshfeti ndodh shpesh/shumë shpesh, 25% e të anketuarve nga ky sondazhi deklaruan se ryshfeti ndodh ndonjëherë, ndërsa një pjesë shumë e vogël e popullatës së intervistuar (rreth 6%) thanë se ryshfeti ndodh rrallë ose shumë rrallë. Ndërkohë, 62% dhe 63% respektivisht e të anketuarve nga sondazhi me publikun thanë se favorët për një palë të tretë dhe favorët për kolegët janë forma shumë të shpeshta të korrupsionit ku përfshihen punonjës të policisë. Favorët që punonjës të policisë marrin nga palë të treta raportohet se ndodhin shpesh/shumë shpesh nga 58% e të anketuarve nga sondazhi publik, dhe një përqindje e ngjashme e të intervistuarve raportonte se shpërdorimi/abuzimi me fondet (53%) dhe pasuritë (52%) e Policisë së Shtetit ndodhin shpesh/shumë shpesh.

Të anketuarve nga publiku iu kërkua të raportonin për llojet e sjelljeve nga oficerët e policisë që publiku mendon se përbëjnë korrupsion, të tilla si manipulimi ose ndryshimi i provave, ose përdorimi i tepruar i dhunës nga një punonjës policie. 49% e të anketuarve nga sondazhi publik besojnë se korrupsioni te punonjësit e policisë shfaqet shpesh ose shumë shpesh në manipulimin e provave nga një skenë krimi dhe 52% e të anketuarve besojnë se dhuna policore ndodh shpesh ose shumë shpesh si rezultat i praktikave korruptive. (Shih Figurën 33).


Figura 33: Ndodhja e akteve të korrupsionit mes punonjësve të Policisë së Shtetit, siç raportohet nga publiku (në %, N = 1099)

Megjithatë, e kundërta raportohet nga sondazhi me policinë, ku korrupsioni, si ryshfeti, favoret, abuzimi me fondet apo pronat, abuzimi me forcën ose manipulimi i provave, raportohet si fenomen që ndeshet rrallë ose asnjëherë. Në fakt, 65% e të anketuarve në sondazhin e policisë besojnë se ryshfeti nuk ndodh kurrë ose ndodh rrallë, dhe 67% raportuan se favoret ndaj palëve të treta nuk ndodhin asnjëherë ose rrallë. Rreth 30% e të anketuarve të policisë raportuan se ndonjëherë vihet re se atyre u ofrohen ryshfet ose favore nga kolegë ose qytetarë. (Shih Figurën 34).

Figura 34: Ndodhja e akteve të korrupsionit mes punonjësve të Policisë së Shtetit, siç raportohet nga policia (në %, N=1099)

Përqindja e të anketuarve në sondazhin publik që mendojnë se ryshfeti ndodh ‘shumë shpesh’ ka rënë ndjeshëm gjatë periudhës kohore të vëzhguar (2014-2020). Nga ana tjetër, perceptimi i të anketuarve nga policia se ryshfeti ndodh shpesh është rritur me 48% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2016. Opinioni publik duket se mendon se korrupsioni, jo në formën e ryshfetit por në formën e shkëmbimit të ndereve/favoreve, është bërë më i shpeshtë me kalimin e kohës. Sondazhet e policisë gjatë kësaj periudhe japin një pamje të përzier në lidhje me përhapjen e favoreve si formë korrupsioni, ku raportohet një rënie e rasteve të përfshirjes së kolegëve të tyre, ndërsa perceptojnë një rritje të rasteve mes punonjësve të policisë dhe palëve të treta. (Shih Figurën 35).

Figura 35: Përqindja e ndryshimit të të anketuarve që raportojnë se praktikat korruptive ndodhin “shumë shpesh”, sipas sondazhit të publikut dhe të policisë, 2014–2020 (në %)




VI.2 Tipologjia dhe ndodhja e sjelljeve korruptive sipas sondazhit të publikut dhe atij të policisë

Plot 57% e të anketuarve nga publiku ishin dakord se punonjësit e policisë kanë lidhje me njerëz nga bota e krimin, përfshirë krimin e organizuar, vetëm 19% e të intervistuarve nuk ishin dakord me këtë pohim, ndërkohë që 23% e të anketuarve kishin qëndrim neutral ndaj këtij pohimi. Përqindja e publikut që ishin dakord se punonjësit e policisë përfshihen në veprimtari të paligjshme është e lartë me 61% e të anketuarve.

Në përgjithësi, publiku nuk është dakord se rekrutimi dhe ngritja në detyrë i oficerëve në Policinë e Shtetit bazohet në meritokraci. 51% e të anketuarve besojnë se rekrutimi nuk është i bazuar në meritokraci, ndërsa, më konkretisht, 56% e të anketuarve janë dakord/plotësisht dakord se emërimi në poste të larta në radhët e Policisë së Shtetit nuk është e bazuar në meritokraci, dhe 52% besojnë se ngritja në detyrë e punonjësve të nivelit bazë dhe të mesëm nuk bazohet në meritokraci. Pjesa e atyre që besojnë se ka meritokraci në Policinë e Shtetit është mjaft modeste, me vetëm 22% të të anketuarve që mendojnë se rekrutimi në përgjithësi bazohet në meritokraci, ku 20% dhe 17% respektivisht besojnë se ka ngritja në detyrë bazohet në meritokraci për gradat e nivelit të mesëm dhe të ulët. 50% e të anketuarve nuk janë dakord me pohimin se prokurimet nga Policia e Shtetit kryhen në përputhje me rregulloret.

Nga ana tjetër, publiku beson se institucioni i Policisë së Shtetit përdoret nga drejtuesit e tij për përfitime politike; 63% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord me pohimin se “drejtuesit e policisë nuk e përdorin institucionin për përfitime politike”. Po ashtu, publiku nuk është dakord/aspak dakord me idenë se punonjësit e policisë bashkëpunojnë me eprorët e tyre ose ndërmjet tyre në luftën kundër korrupsionit, përkatësisht me 52% dhe 42% të të anketuarve.

Figura 36: Perceptimi i publikut për praktikat korruptive në rekrutimin, udhëheqjen dhe prokurimin nga Policia e Shtetit (në %, N=1099)




Ka një shpërndarje të ngjashme në përgjigjet e publikut dhe të policisë për shumë prej pohimeve që lidhen me faktorë të ndryshëm që shpjegojnë pse përhapet korrupsioni në polici. Lidhjet mes punonjësve të policisë dhe botës së krimit dhe përfshirja e tyre në veprimtari të paligjshme ishin një kategori e tillë; rreth 55% e policëve të anketuar besojnë se punonjës të policisë kanë lidhje/njohje me botën e krimit dhe janë të përfshirë në aktivitete të paligjshme.

Për më tepër, gjysma e të anketuarve në sondazhin e policisë nuk ishin dakord se rekrutimi dhe ngritja në detyrë bazohen në meritokraci, ndërsa 50% e tjerë e të anketuarve ishin ose neutral ose nuk ishin dakord se ka meritokraci kur bëhet fjalë për rekrutimin e oficerëve të rinj të policisë ose emërimin e oficerëve në nivele më të larta.

Megjithatë, pikëpamjet ndryshonin kur bëhej fjalë për prokurimet; 51% e punonjësve të anketuar të policisë thanë se ishin dakord / plotësisht dakord që prokurimi në polici kryhej në përputhje me rregulloret, krahasuar me të njëjtën përqindje të publikut që nuk ishin dakord/aspak dakord. Rezultatet nga sondazhi me policinë raportuan, nga ana tjetër, një ndjenjë më të fortë sesa publiku se punonjësit e policisë dhe eporët e tyre bashkëpunojnë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit; 66% e të anketuarve të policisë ishin dakord/plotësisht dakord me pohimin se punonjësit e policisë bashkëpunojnë mes tyre, dhe 44% e të anketuarve besojnë se ekziston bashkëpunim mes oficerëve të policisë dhe hierarkisë së tyre në këtë luftë. 50% e oficerëve të policisë duket se kanë konfirmuar një perceptim që

drejtuesit e Policisë së Shtetit janë nën ndikimin e politikës, duke mos rënë dakord / aspak dakord se policia nuk përdoret kurrë nga drejtuesit për përfitime politike. (Shih Figurën 37).

Figura 37: Perceptimi i policisë për praktikën e korrupsionit në rekrutimin, udhëheqjen dhe prokurimet nga Policia e Shtetit (në %, N=253)



VII. NDIKIMI I FAKTORËVE KULTURORË, SJELLORË, DHE INSTITUCIONALË TE KORRUPSIONI

Publikut iu kërkua të raportonte edhe për ndikimin e faktorëve kulturorë/sjellorë dhe institucionalë për nivelin e perceptuar të korrupsionit në Policinë e Shtetit. Ndër faktorët që publiku mendonte se ka ndikim të madh në nivelin e korrupsionit janë pranimi në përgjithësi i korrupsionit në shoqëri, roli i ndikimit politik dhe pagat e ulëta ose kushtet e këqija të punës. Edhe faktorët që lidhen me kulturën institucionale, menaxhimin në Policinë e Shtetit ose kapacitetin profesional të punonjësve të policisë u raportuan se nxisin korrupsionin, por në një shkallë më të vogël.

Pikat kryesore

- Faktorët me shumë ndikim në nxitjen e korrupsionit, siç raportohet nga sondazhi me publikun, janë pranimi në përgjithësi i korrupsionit nga shoqëria; ndikimi politik; dhe pagat e ulëta ose kushtet e këqija të punës për punonjësit e policisë. Edhe faktorët që lidhen me kulturën institucionale, menaxhimin ose trajnimet e dobëta të punonjësve të policisë u raportuan se nxisin korrupsionin, por në një shkallë më të vogël.
- 69% e të anketuarve nga sondazhi me publikun besojnë se pranimi i korrupsionit nga publiku ka një ndikim të fortë/shumë të fortë, ndërsa 74% e të anketuarve besojnë se toleranca ndaj korrupsionit mes punonjësve të policisë krijon një mjedis për shfaqjen e praktikave korruptive.
- Perceptimi i publikut dhe ai i policisë për faktorët që nxisin korrupsionin janë mjaft të ndryshëm, përveç atyre që kanë të bëjnë me pagat e punonjësve të policisë dhe kushtet e tyre të punës. 78% e të anketuarve në sondazhin publik dhe 60% e të anketuarve në sondazhin me policinë besojnë se pagat kanë një ndikim të fortë/shumë të fortë te korrupsioni.
- Përqindja e policëve të anketuar që vlerësojnë se kushtet e punës janë të këqija ishte 28% e të gjithë kampionit. Pjesa më e madhe e oficerëve të policisë (48%) vlerësojnë se kushtet e tyre të punës janë të pranueshme.
- Pranimi dhe toleranca ndaj korrupsionit nga publiku është e ulët. Si për kontrast, punonjësit e policisë raportojnë një tolerancë më të madhe ndaj korrupsionit. Përqindja e publikut që konsideroi veprime të tilla si punonjës policie që pranojnë/japin favore, pranojnë të mira materiale apo shërbime falas dhe shkelin vetë rregullat si veprime korruptive ishte përkatësisht 85%, 69% dhe 78%. Publiku është përgjithësisht mbështetës ndaj punonjësve të policisë që kanë një punë të dytë, nëse kjo punë nuk

bie ndesh me rolin e tyre si punonjës policie. Megjithatë, publikut nuk është tolerant ndaj punonjësve të policisë që fshehin lidhjet e kolegëve të tyre me botën e krimit.


- Vetëm 48% e të anketuarve në sondazhin me policinë e konsiderojnë mosndëshkimin e një kolegu për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor si veprim të korruptuar. Manipulimi i provave konsiderohet korrupsion nga 59% e policëve të anketuar, ndërsa shkelja e etikës dhe përdorimi i gjuhës diskriminuese zakonisht tolerohet si nga publiku ashtu edhe nga policia.

VII.1 Perceptimi i publikut dhe policisë për faktorët që ndikojnë te korrupsioni në Policinë e Shtetit

77% e të anketuarve nga publiku besojnë se niveli i përgjithshëm i korrupsionit në Shqipëri ka një ndikim të fortë ose shumë të fortë në nivelin e korrupsionit në polici në mënyrë të veçantë. Pranimi i korrupsionit nga publiku me qëllim mbarimin e punëve si dhe toleranca ndaj korrupsionit të punonjësve të policisë renditen si nxitës të fortë dhe shumë të fortë të korrupsionit. 69% e të anketuarve besojnë se pranimi nga publiku i korrupsionit ka një ndikim të fortë dhe 74% e të anketuarve besojnë se toleranca ndaj korrupsionit mes punonjësve të policisë nxit korrupsionin.

Ndër faktorët që lidhen me kushtet e punës dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, niveli i pagave duket se perceptohet si faktori me ndikimin më të fortë në korrupsion; 78% e të anketuarve në sondazhin publik raportuan se besojnë se pagat e ulëta kanë një ndikim të fortë dhe shumë të fortë në korrupsion. 61% dhe 64% përkatësisht të njerëzve të anketuar raportuan se menaxhimi i pabazuar në meritokraci i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit ose menaxhimi i dobët ka ndikim të fortë ose shumë të fortë në korrupsion. 62% e të anketuarve e identifikojnë kulturën institucionale si një faktor të fortë ose shumë të fortë në nxitjen e korrupsionit, ndërsa 56% e të anketuarve identifikojnë trajnimin e ulët profesional të punonjësve të policisë si faktor të fortë ose shumë të fortë në korrupsion. (Shih Figurën 38).


Figura 38: Perceptimi i publikut për faktorët që ndikojnë në korrupsionin në Policinë e Shtetit (në %, N=1099)




Perceptimi i publikut dhe ai i policisë për faktorët që nxisin korrupsionin janë dukshëm të ndryshëm, përveç atyre që kanë të bëjnë me pagat e punonjësve të policisë dhe kushtet e tyre të punës, kur mes dy perceptimeve kemi nivel pothuajse të barabartë. 67% e publikut mendon se pagat e ulëta kanë një ndikim të fortë ose shumë të fortë në korrupsion, ndërkohë që 60% e të anketuarve në polici besojnë të njëjtën gjë.

Oficerët e policisë i kushtojnë krahasimisht më pak vëmendje ndikimit të të gjithë faktorëve të tjerë në korrupsion në krahasim me publikun. Vetëm 33% e të anketuarve në sondazhin e policisë besojnë se niveli i përgjithshëm i korrupsionit në Shqipëri ka ndikim të fortë ose shumë të fortë në korrupsionin në polici; 28% thonë se pranimi i korrupsionit nga publiku ka një ndikim po aq të fortë në korrupsion; dhe së fundmi 21% e të anketuarve të policisë besojnë se toleranca ndaj korrupsionit nga punonjësit e policisë nxit korrupsionin. Roli i ndikimit politik mbi korrupsionin perceptohet si i ulët, me vetëm 37% të të anketuarve që besojnë se ndikimi politik është nxitës i fortë ose shumë i fortë. (Shih Figurën 39).

Figura 39: Perceptimi nga publiku dhe policia e ndikimit të fortë të faktorëve të ndryshëm të korrupsionit (në %)




Rezultatet e sondazhit me policinë e drejtojnë gishtin më shumë te ndikimi i kulturës institucionale dhe menaxhimi në nxitjen e korrupsionit në polici sesa faktorët e jashtëm, si kultura ose ndikimi politik. 41% e të anketuarve të policisë identifikojnë rekrutimin dhe gradimin jo të bazuar në meritokraci dhe trajnimin e ulët profesional si nxitës të fortë ose shumë të fortë të korrupsionit. Përkatësisht 43% 45% e të anketuarve nga policia identifikuan kulturën institucionale dhe menaxhimin e dobët si faktorë të fortë ose shumë të fortë. (Shih Figurën 40).

Figura 40: Perceptimi nga policia e ndikimit të faktorëve të korrupsioni (në %, N=253)

Duke qenë se kushtet e punës, veçanërisht pagat dhe ngritja në detyrë, u identifikuan si nxitës të korrupsionit si nga publiku ashtu edhe nga punonjësit e policisë, u kërkua më shumë evidencë se si perceptohen kushtet e punës nga publiku dhe vetë policia.


Përqindja e të anketuarve nga sondazhi publik që raportojnë se kushtet e punës janë të këqija ishte 17% e totalit të kampionit. 11% e të anketuarve raportuan se kushtet e punës janë shumë të mira. Pjesa më e madhe e publikut, 69% e të anketuarve, i perceptojnë kushtet e punës si të pranueshme ose të mira. Të anketuarit meshkuj kanë tendencë t'i perceptojnë kushtet e punës së punonjësve të policisë si të këqija më shpesh sesa femrat (19% krahasuar me 15%), ndërkohë që edhe të anketuarit nga zonat rurale i konsiderojnë më shpesh kushtet e punës së policisë si të këqija. Të anketuarit më të rinj, individë me nivel të lartë arsimor dhe ata të punësuar kishin një perceptim më të fortë se kushtet e punës për oficerët e policisë janë të këqija. (Shih Figurën 41).

Figura 41: Perceptimi i publikut për kushtet e punës së policisë (në %, N=1099)

Përqindja e të anketuarve nga sondazhi i policisë që i konsideruan kushtet e punës si të këqija ishte 17% e të gjithë kampionit. Një pjesë e konsiderueshme e oficerëve të policisë i vlerësuan kushtet e tyre të punës si të pranueshme (40%). Përqindja e oficerëve të policisë që i konsideronin kushtet e tyre të punës si të mira/shumë të mira ishte 29%, ndërsa 11% refuzuan të përgjigjen. Oficeret femra raportuan më shpesh se kushtet e punës janë të këqija.


Sipas departamenteve, përfaqësuesit e Policisë Rrugore raportuan më shpesh se kushtet e punës janë të këqija (19%). Përqindja më e ulët e të anketuarve nga policia që mendojnë se kushtet e punës janë të këqija ishte tek punonjësit e policisë me më shumë se 30 vite përvojë pune. (Shih Figurën 42).

Figura 42: Perceptimi i të anketuarve nga policia për kushtet e tyre të punës (në %, N=253)



Plot 68% e punonjësve të policisë nuk janë dakord se pagat për oficerët e rangut të mesëm dhe të ulët janë të mjaftueshme për një jetesë normale. U raportua një perceptim i ekuilibruar për pagat për oficerët e rangut të lartë. Përqindja e atyre që janë dakord dhe nuk janë dakord se pagat për oficerët e rangut të lartë janë të mjaftueshme për një jetesë normale ishte pothuajse e njëjtë. Përgjigja ndaj idesë se vetingu do të ulë korrupsionin në mënyrë efektive në polici ishte, po ashtu, e barabartë mes atyre që janë dakord ose plotësisht dakord dhe atyre që nuk janë dakord ose aspak dakord, me 42% që janë dakord dhe 44% që nuk janë dakord. 46% e punonjësve të policisë raportojnë se kodi i etikës ka ndihmuar në uljen e korrupsionit në polici. Po ashtu, 51% e të anketuarve në sondazhin e policisë besojnë se rregullorja e brendshme e Policisë së Shtetit zvogëlon hapësirat për praktika korruptive dhe ndihmon në luftën kundër korrupsionit në institucione. (Shih Figurën 43)


Figura 43: Kushtet e punës dhe kultura institucional sipas sondazhit të policisë (në %, N=255)




VII.2 Toleranca ndaj korrupsioni te publiku dhe policia

Niveli i tolerancës së publikut ndaj korrupsionit matet duke përdorur përgjigjet e tyre nëse situata të caktuara mendohen si korrupsion apo jo, të tilla si në rastin kur një punonjës policie shkel rregullat e qarkullimit rrugor dhe kolegët e tij nuk e ndëshkojnë atë, ose kur një punonjës manipulon provat me qëllim arrestimin më shpejt të një personi. Në sondazh të anketuarit u pyetën për të identifikuar nëse ai/ajo e konsideronte një situatë të caktuar si korrupsion apo jo. Përqindja e përgjigjeve 'Po' dhe 'Jo' përmbledhen në figurën 44.

78% e të anketuarve raportojnë se mosndëshkimi i një punonjësi policie kur ai shkel rregullat e trafikut është një korrupsion. Evidentohet një nivel më i ulët tolerance për situatën kur një punonjës policie ndihmon dikë të marrë një shërbim që ai ose ajo nuk ka të drejtë ta marrë, me 85% të të anketuarve që e konsiderojnë këtë një praktikë korruptive. 69% e individëve të anketuar thanë se kur një oficeri policie merr një mall ose shërbim falas nga dikush që ka një biznes është korrupsion. 68% e të anketuarve nga sondazhi publik e konsideruan korrupsion rastin kur një punonjës policie ndryshonte ose manipulonte provat nga një skenë krimi për të lehtësuar një arrestim. Nuk duket se korrupsioni dhe diskriminimi perceptohen si të lidhur me njëri tjetrin, duke pasur parasysh se vetëm 48% e individëve të anketuar thanë se një oficer policie që përdor një gjuhë diskriminuese ndaj një qytetari mund të konsiderohet si korrupsion.


Figura 44: Perceptimi publik për korrupsionin në situata të ndryshme (në %, N=1099)

Oficerët e policisë raportojnë një nivel më të lartë tolerance ndaj situatave korruptive në krahasim me publikun dhe për të gjitha situatat e listuara kishin një prirje më të ulët për t'i konsideruar ato si raste korrupsioni. Vetëm 48% e të anketuarve të policisë e konsiderojnë si korrupsionin rastin kur një punonjës policie jashtë detyre shkel rregullat e trafikut rrugor dhe kolegu i tij nuk e ndëshkon atë, 34% nuk e konsiderojnë këtë rast si korrupsion, ndërsa 18% zgjedhën të mos përgjigjeshin. Një punonjës policie që ndihmon dikë të përfitojë padrejtësisht nga një shërbim që ai/ajo nuk ka të drejtë konsiderohet si veprim korruptiv nga 61% e policëve të anketuar, 56% e të anketuarve menduan se një punonjës policie që merrte të mira materiale ose shërbime falas nga dikush që ka një biznes ishte rast korrupsioni. Manipulimi i provave nga një punonjës policie me qëllim arrestimin më të shpejtë të një personi të dyshuar për kryerjen e një veprë penale është korrupsion për 59% të policëve të anketuar. Përdorimi i gjuhës diskriminuese dhe ofenduese nga një oficer policie nuk shihet si korrupsion nga 45% e të anketuarve nga policia, gjë që është e ngjashme me perceptimin e publikut. (Shih Figurën 45)

Figura 45: Perceptimi i policisë për korrupsionin në situata të ndryshme (në %, N=255)


Rreth 63% e të anketuarve në sondazhin me publikun janë dakord/plotësisht dakord me pohimin se punonjësit e policisë mund të kenë një punë të dytë nëse kjo nuk bie ndesh me rolin dhe përgjegjësitë e tyre aktuale si punonjës policie. Për më tepër, 55% e të anketuarve nuk mendonin se të kesh një punë të dytë mund të rrezikonte efektivitetin e punonjësve të policisë në punën e tyre. Një përqindje e konsiderueshme e publikut mendonte se punonjësit e policisë duhet të raportonin raste korrupsioni (79%), çdo kontakt të kolegëve me persona me rekorde kriminale ose pjesë e krimit të organizuar (78%), si dhe raste kur punonjësit e policisë përfshihen vetë në veprimtari kriminale (82%). (Shih Figurën 46)

Figura 46: Opinioni publik për vepra/situata që tolerohen si jo korrupsion (në %, N=1099)



Të anketuarit në sondazhin e policisë janë dakord ose plotësisht dakord se për një punonjës policie që ka një punë të dytë që nuk bie ndesh me detyrën e policit nuk është një korrupsion (65%), duke kundërshtuar mendimin se një punë e dytë mund të ndikojë në efektivitetin e një punonjësi policie në detyrat e tij të përditshme (përqindja që nuk janë dakord/aspak dakord është 59%). Fatmirësisht, të anketuarit nga policia që janë dakord se denoncimi i kolegëve/eporëve që kanë kontakte dhe janë të përfshirë në krimin e organizuar apo në korrupsion është gjëja e duhur dhe duhet të bëhet. Përqindja e atyre që janë dakord/nuk janë dakord se shkelja e ligjit që rrit efikasitetin e policisë nuk duhet të ndëshkohet është pothuajse e barabartë (40% krahasuar me 41%). (Shih Figurën 47).

Figura 47: Përqindja e punonjësve të policisë që i konsiderojnë pohimet e listuara si vepra jo-korruptive (në %, N=1099)



VIII. NJOHURITË DHE PERCEPTIMI I PUBLIKUT DHE POLICISË PËR ANTI-KORRUPSIONIN


Pikat kryesore

- Besimi i publikut në aftësinë dhe vullnetin e policisë për të luftuar korrupsionin është mjaft i fortë, ku 65% e të anketuarve raportojnë se e shohin si të mundshme/plotësisht të mundshme që policia të luftojë korrupsionin. Ky besim shfaqet edhe më i fortë tek të rinjtë.
- Punonjësit e policisë raportojnë një besim shumë më të fortë në aftësinë e policisë për të luftuar korrupsionin, ku 87% e të anketuarve nga sondazhi i policisë raportojnë se besojnë se është plotësisht e mundur ose e mundur që Policia e Shtetit të luftojë korrupsionin.
- 45% të intervistuarve raportojnë se kanë pak ose aspak njohur për kuadrin ligjor anti-korrupsion dhe për ndërhyrjet me politika.
- Në përgjithësi, vetëm 12% e të anketuarve raportuan se kuadri ligjor aktual është i përshtatshëm për luftën kundër korrupsionit.
- Punonjësit e policisë raportojnë se kuadri ligjor dhe ndërhyrjet e politikave për të luftuar korrupsionin në Policinë e Shtetit kanë nevojë për përmirësime, pasi ato nuk janë shumë të përshtatshme. 58% e të anketuarve të policisë raportuan se kuadri ligjor ka pak ose aspak aftësi për të luftuar korrupsionin.
- Procesi i vetingut në Policinë e Shtetit është i njohur për publikun, siç konfirmohet nga 66% e njerëzve të intervistuar. Opinioni publik për idenë se procesi i vetingut do të jetë një masë e suksesshme anti-korrupsioni për Policinë e Shtetit ishte i ndarë në mënyrë të barabartë mes atyre që “kanë besim” dhe atyre që “nuk kanë besim”. Megjithatë, punonjësit e policisë raportuan një shkallë të lartë besimi se vetingu do ta ndihmojë policinë të përmirësojë integritetin e saj dhe të luftojë korrupsionin; 70% e të anketuarve nga sondazhi me policinë konfirmojnë se kanë besim/ shumë besim në një farë mase te vetingu.

VIII.1 Besimi i publikut dhe policisë në kapacitetin e policisë për të luftuar korrupsionin

Publiku në përgjithësi ka besim në aftësinë dhe kapacitetin e policisë për të luftuar korrupsionin, me 65% të të anketuarve që raportojnë se e shohin si të mundshme/plotësisht të mundshme që policia të luftojë korrupsionin. Ky besim duket më i fortë mes të anketuarve të rinj në moshë, mes atyre në qarqet veriore të vendit dhe të anketuarve të punësuar në sektorin publik. Punonjësit e policisë raportuan një besim shumë më të fortë në aftësinë e policisë për të luftuar korrupsionin. 87% e të anketuarve nga sondazhi i policisë raportuan se besojnë se është e mundur ose plotësisht e mundur që Policia e Shtetit të luftojë korrupsionin. Vetëm 10% e oficerëve të policisë tregojnë mungesë besimi në aftësinë e policisë për të pasur sukses në luftën e saj kundër korrupsionit. (Shih Figurën 48)

Figura 48: Përqindja e të anketuarve nga publiku dhe policia që besojnë në aftësinë e policisë për të luftuar korrupsionin (në %, N=1099, N=255)




VIII.2 Ndërgjegjësimi i publikut dhe policisë për kuadrin anti-korrupsion

Njohuritë e publikut për kuadrin ligjor dhe strategjik për luftën kundër korrupsionit për Policinë e Shtetit janë një faktor i rëndësishëm për perceptimin e tyre për korrupsionin, për perceptimin për integritetin e policisë dhe për besimin e tyre tek ky institucion. Si i tillë, publikut iu kërkua të thoshte nëse kanë njohuri për kuadrin ligjor dhe strategjik për luftën kundër korrupsionit. 45% e individëve të intervistuar raportuan se nuk kanë fare ose kanë pak njohuri për kuadrin aktual anti-korrupsion; rreth 19% e qytetarëve raportuan kanë njohuri të mjaftueshme deri në shumë të mira për nismat anti-korrupsion, qofshin ato nisma politike apo ligjore.

Niveli i njohurive për masat anti-korrupsion është më i ulët te femrat, njerëzit që jetojnë në zonat urban përkundër atyre që vijnë nga zonat rurale, mes të moshuarve, te njerëzit me arsim parauniversitar dhe atyre me të ardhura të ulëta. Nivel më i lartë njohurish për masat anti-korrupsion dhe kuadri ligjor raportohet te njerëzit me arsim të lartë, tek ata që janë të punësuar në sektorin publik dhe te njerëzit me nivel të lartë të të ardhurave. (Shih Figurën 49).

Sondazhi me policinë tregoi se, te punonjësit të e policisë, përqindja e atyre që thanë se niveli i njohurive të tyre për kuadrin strategjik anti-korrupsionin është i mjaftueshëm/i plotë ishte 58%. Përqindja e punonjësve të policisë që kanë disa njohuri është e ngjashme me atë të të gjithë popullatës, ndërsa përqindja e atyre që kanë pak ose aspak informacion ngushtohet në 14% të kampionit. (Shih Figurën 49).

Figura 49: Niveli i njohurive për kuadrin ligjor dhe strategjik anti-korrupsion te të anketuarit e publikut dhe policisë (në %, N=1099, N=255)




Të anketuarit nga publiku dhe policia u pyetën për përshtatshmërinë e kuadrit ligjor dhe politikave anti-korrupsion. Duke pasur parasysh përqindjen e madhe të atyre që u përgjigjën se kanë pak ose aspak njohuri për kuadrin ligjor dhe nismat e politikave anti-korrupsionin, pritej që përqindja e individëve që nuk janë në gjendje të kuptojnë sa të përshtatshme janë masat anti-korrupsion të ishte e konsiderueshme. Në fakt, 20% e të anketuarve u përgjigjën se “nuk ishin në gjendje të kuptonin nëse kuadri ligjor ishte i përshtatshëm për të luftuar korrupsionin”. Në përgjithësi, vetëm 12% e të anketuarve raportuan se kuadri ligjor është shumë i përshtatshëm për luftën kundër korrupsionit; 32% besojnë se kuadri ligjor dhe i politikave është i përshtatshëm; ndërsa 37% e popullatës së anketuar besonte se duhej bërë më shumë si për kuadrin ligjor anti-korrupsion ashtu edhe për ndërhyrjet në politika, pasi i perceptonin ato si të papërshtatshme ose disi të përshtatshme.

Punonjësit e policisë raportojnë se kuadri ligjor dhe ndërhyrjet e politikave për luftën kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit kanë nevojë për përmirësim. 58% e të anketuarve


të policisë në sondazh raportuan se kuadri ligjor është pak ose aspak i përshtatshëm për të luftuar korrupsionin. 34.4% e punonjësve të policisë të intervistuar thanë se ligjet dhe politikave janë shumë të përshtatshme, vetëm 6.5% e punonjësve të policisë nuk ishin në gjendje të jepnin mendimin e tyre për përshtatshmërinë e kuadrit ligjor dhe të politikave për luftën kundër korrupsionit. (Shih Figurën 50 dhe Shtojca 2).

Figura 50: Përqindja e të anketuarve që e konsiderojnë kuadrin ligjor anti-korrupsion të përshtatshëm, sipas sondazhit të publikut dhe policisë (në %, N=1099, N=255)




Procesi i vetingut mes punonjësve të policisë është i njohur nga 66% e popullatës së intervistuar. Të anketuarit meshkuj në të gjithë kampionin, ata me arsim të lartë dhe individët që punojnë në sektorin publik kanë më shumë gjasa të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për procesin e vetingut në polici si një ndërhyrje për luftën kundër korrupsionit.

Figura 51: Përqindje e publikut që raporton se kanë informacione për procesin e vetingut në polici (në %, N=1099)



Besimi i publikut në idenë se procesi i vetingut do të jetë një masë e suksesshme anti-korrupsioni është i lartë; 22% e të anketuarve raportuan se kanë plotësisht besim ose besim të mjaftueshëm në procesin e vetingut; 24% e publikut tregohet i kujdesshëm duke deklaruar se kanë “deri diku besim”; 42% e të anketuarve raportuan se nuk kanë besim/ kanë pak besim në procesin e vetingut si masë anti-korrupsion.

Figura 52: Përqindja e të anketuarve nga publiku dhe policia që raportojnë se kanë besim te procesi i vetingut (në %, N=1099, N=255)



Të anketuarit nga policia raportuan një shkallë të lartë besimi se vetingu do ta ndihmojë Policinë e Shtetit të përmirësojë integritetin e saj dhe të luftojë korrupsionin, ku 41% thanë se kanë besim/ besim të plotë në procesin e vetingut. Përqindja e punonjësve të policisë që dyshojnë në aftësinë e vetingut për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit dhe për të rikthyer integritetin e Policisë së Shtetit arrin në 24.7% të punonjësve të policisë.

BIBLIOGRAFIA

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, (2014). ‘Integriteti dhe korrupsioni Policor në Shqipëri’, gjendet në adresën: https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/12/Integriteti_dhe_korrupsioni_web_ENG.pdf

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, (2016). ‘Integriteti dhe korrupsioni Policor në Shqipëri 2.0’, gjendet në adresën: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ‘Raporti i Monitorimit të Procesit të Vetingut në Polici 2020’, gjendet në adresën: <https://idmalbania.org/download/7927/>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim,, ‘Raport i Monitorimit të Procesit të Vetingut në Polici 2020’, gjendet në adresën: <https://idmalbania.org/download/7927/>

Ligji Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

Ligji Nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”

Ligji Nr. 74/2020 (18/6/2020), me shtesat dhe ndryshimet në Ligjin Nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme” Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 39, 2379–2435, <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/39/e052fc58-ab5d-4f90-ae18-9cfc907f678>.

Ministria e Brendshme, ‘Vetingu në Polici: Udhëzues për vlerësimin e punonjësve në PSH, GR, SHÇBA’, gjendet në adresën: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Guida_e_Vettingut.pdf.

S. Kutnjak Ivković, M. R. Haberfeld and R. Peacock (2019). ‘Overlapping Shades of Blue: Exploring Police Officer, Supervisor, and Administrator Cultures of Police Integrity’ in *Exploring Police Integrity Novel Approaches to Police Integrity Theory and Methodology*. Springer.

Urdhri i Ministrisë të Brendshme, Nr. 904 (15/9/2017) “Ngritja e një grupi pune për të ndërmarrë një analizë të plotë të korrupsionit brenda strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA).

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 247 (datë 20/03/2015), “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015–2020”, Fletorja Zyrtare, 31 mars 2015, gjendet në adresën: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/472015.pdf

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 702 (datë 26/8/2015), “Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015–2020 dhe Plani i Veprimit 2015–2017”, gjendet në adresën: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Strategjia_e_Rendit_Publik_2015%E2%80%932020_dhe_Plani_i_Veprimit_2015%E2%80%932017.pdf

SHTOJCAT

Shtojca 1: Statistikat përshkruese të Sondazhit me Publikun

Shtojca 1: Statistikat përshkruese të Sondazhit me Publikun			
Pyetja	Kategoritë e përgjigjeve	Frekuenca (në nr.)	Frekuenca (në %)
Përfaqësimi gjeografik në bazë qarku	Berat	48	4.4%
	Diber	45	4.1%
	Durres	128	11.6%
	Elbasan	116	10.6%
	Fier	111	10.1%
	Gjirokaster	23	2.1%
	Korce	80	7.3%
	Kukes	30	2.7%
	Lezhe	48	4.4%
	Shkoder	77	7%
	Tiranë	321	29.2%
	Vlorë	72	6.6%
Përfaqësimi urban - rural	Urban	611	55.7%
	Rural	486	44.3%
Gjinia	Mashkull	544	49.5%
	Femër	555	50.5%
Grupmosha	18-25 vjeç	170	15.5%
	26-35 vjeç	240	21.8%
	36-45 vjeç	204	18.6%
	46-55 vjeç	217	19.7%
	56-65 vjeç	165	15%
	Mbi 65 vjeç	103	9.4%
Niveli arsimor	Pa arsim	14	1.3%
	Arsim fillor - 4 vjeçar	64	5.8%
	Arsim 8/9 - vjeçar	212	19.3%
	Arsim i mesëm	480	43.7%
	Arsim universitar/ pasuniversitar Education	327	29.8%
	Refuzim	2	0.2%

Statusi i punësimit	I/E punësuar në sektorin privat	291	26.5%
	I/E punësuar në sektorin publik	133	12.1%
	I/E vetëpunësuar	179	16.3%
	I/e papunë	232	21.1%
	Student	98	8.9%
	Pensionist	156	14.2%
	Tjetër	7	0.6%
	Refuzim	3	0.3%
Niveli i të ardhurave	Nuk kam të ardhura	341	31%
	[deri në 24000 Lek/Muaj]	239	21.7%
	[Nga 24001 - 50000 Lek/Muaj]	319	29%
	[Nga 50001-70000 Lek/Muaj]	122	11.1%
	[Mbi 70000 Lek/Muaj]	34	3.1%
	Refuzim	44	4%
Gjatë 12 muajve të fundit, a keni dëgjuar të flitet për korrupsion në Policinë e Shtetit?	Po	955	86.9%
